



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”

i

**Institucionit të arsimit të lartë Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Vjollca Durro

2. Dr. Nevila Heta

Qershor/ 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423



web site: www.ascal.al

Faqe 1

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermieristikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor "Infermieri e Përgjithshme"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH nr.2273 prot., datë 05.06.2001
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh nr.266, dt. 10.08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2021- 2022):	11/ 58
18	Numri i studentëve (2019- 2022):	684 student
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” zhvillohet në Departamentin e Infermieristikës të Fakultetit i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, hapur me Shkresë MASH nr.2273 prot., datë 05.06.2001.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani Elbasan”(UNIEL) është një institucion publik i arsimit të lartë i Liçencuar me VKM 414, datë 03 .12.1991 të Ministrisë së Arsimit i cili miratoi kthimin e Institutit të Lartë pedagogjik në UNIEL. UNIEL është riakredituar me VBA Nr. 49, date 27.11.2020 dhe përbëhet nga pesë fakultete:

Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave Humane; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; Fakulteti i Shkencave të Edukimit; Fakulteti i Shkencave të Natyrës, që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, natyrës, edukimit, humane dhe mjekësore.

Programi i studimit Bachelor “Infermieri e Përgjithshme” (IP) zhvillohet në Departamentin e Infermieristikës (DI) të Fakultetit i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT).

Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” është hapur për herë të parë me Urdhër Nr Prot. 2273, date 05/06/2001 të MASH, si kurs studimi, pranë Departamentit të Biologjisë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkëputje nga puna me kohëzgjatje 3.5 vite akademike. Më vonë program u organizua sipas sistemit të Bolonjës dhe në vitin 2008-2009 u emërtua “Bachelor në Infermieri të përgjithshme”. Në vitin 2012 me hapjen e FSHMT Programi Bsc në Infermier i Përgjithshëm bëhet pjesë e FSHMT dhe zhvillohet pranë Departamentit të Infermieristikës. Ky program është organizuar dhe strukturuar në përputhje më statusin dhe rregulloren e institucionin, ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme”, i ofruar nga Fakultetin Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

- I. Ofrimi i programit të studimit,
- II. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
- III. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
- IV. Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit;
- V. Studentët dhe mbështetja e tyre;
- VI. Sigurimi i cilësisë në programin e studimit.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Nevila Heta, Prof. Dr. Vjollca Durro. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aviola Bardhi.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UNIEL e zhvilluar në datat 22-23 Janar 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UNIEL.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 08.05.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/63 Prot., datë 08.05.2023 dërgohet në Institutcion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 15.05.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr 642/ 44 Prot., datë 15.05.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institutcionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

1. Standardi II.1/kriteri 3

Lidhur me konstatimet në këtë standart kriteri 3 GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit ne veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ETC/ përqindje nuk përputhet me ato të parashikuar në VKM “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë si : Lëndët plotësuse përbëjnë 27 % nga 10-15% të parashikuar në VKM përkatëse, Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 7% nga 12-15% të parashikuar dhe Lëndë bazë 25 % nga 15%-20% parashikuar.

GVJ është referuar dokumentacionit tuaj të uploaduar në sistemin ASCAL Evidenca 2.19: Të dhëna të plota për kërkimin shkencor. Tabela 9 (fq17-18). ,

Pranojmë komentin për: Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 7 % është 15% pas rillogaritjeve të bëra. **Konstatimi i bërë nga GVJ për Standardi II.1/ kriteri 3 qëndron.**

2. Standarti II.1/ Kriteri 5. Lidhur me këtë standard

Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e pedagogëve është më e madhe se normat e përcaktuar nga MASH dhe ka pedagogë që japin më shume se tre lëndë.

Konstatimi i bërë nga GVJ qëndron.

Komenti i bërë lidhur me vlerësimin e Standardit nga programi i studimit është i drejtë dhe pranohet nga GVJ.

2. Standardi II.4/ kriteri 5

Literatura e detyruar në fund të cdo syllabusi si tekset mësimore nuk kanë datën e botimit. Gjithashtu dhe literatura e rekomanduar nuk ka datë botimi. GVJ i është referuar sylabuseve të uploaduar në faqen e ASCAL-it. **Konstatimi i bërë nga GVJ qëndron.**

Konkluzione për vlerësimin e standartit IV:

GVJ është dakort me vlerësimin perfundimtar "Plotësisht" të standartit IV dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në RVJ.

STANDARTI IV

1. Standardi IV.1/kriteri 2

Komenti i institucionit: GVJ kostaton se ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë, që japin lëndë të tipologjive të ndryshme apo që nuk përputhen me formin tyre profesional/specialitetin. GVJ konsideron me vend rekomandimin e GVJ, të cilin departamenti ka filluar që në vitin akademik 2022-2023 të marrë parasysh rishpërndarjen e lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme. FSHMT ka vepruar sipas nevojave në vitet në vazhdimësi duke rekrutuar vit pas viti specialistë sipas specifikave të lëndëve.

Përsa i përket ngarkesës mësimore të stafit akademik, UE me vendim të Bordit të Administrimit ka paguar deri në 300 ore suplementare referuar evidencave mësimore të secilit pedagog.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në raport.

Standardi IV.1/Kriteri 7

Komenti i institucionit: GVJ deklaron se marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të shërbimit shëndetësor i ka kaluar afati.

GVB ju vë në dispozicion evidencat "EVIDENCA 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave si edhe bashkëlidhur këtij dokumenti marrëveshjet e rinovuara në vitin 2022.

Gjithashtu ju evidentojmë se disa marrëveshje e kanë të specifikuar në kontratë që rinovohen në heshtje.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në RVJ.

2. Standardi IV.3/ Kriteri 2

Komenti i institucionit: GVJ gjatë vizitës në bibliotekë evidentoi që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar si edhe që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe shpesh herë bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët.

GVB ju ri-evidenton që literatura e detyruar dhe e rekomanduar e huaj e cila përdoret si literaturë mbështetëse është personale e siguruar nga vetë pedagogu ose mund të aksesohet online nga platformat u-library dhe JSTORE (EVIDENCA 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library), për këtë arsye nuk mund të gjendet kopje fizike në bibliotekë. Kjo literaturë iu rekomandohet studentëve nga pedagogu të cilën ata e aksesojnë në libraritë online të sipër përmendura. Gjithashtu ju vëmë në dijeni se syllabuset janë rifreskuar tashmë për vitin akademik 2022-2023 me literaturë të fundit bashkëkohore si referim kryesor për përgatitjen e leksioneve të shkruara e përshtatur nga vetë pedagogët.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur ne RVJ. Syllabuset e vëna ne dispozicin kanë literature të vjetëruar, gjithashtu theksojme se Literatura e detyruar nuk mund të jetë me shumë se një ose dy tituj dhe duhet të jetë disponibël në hard-copy dhe në gjuhën shpise.

3. Standardi IV. 3/ Kriteri 4

Komenti i institucionit: GVJ shkruan në draft raport se vlerëson rritjen e vazhdueshme vit pas vitit të buxhetimit të bibliotekës, por panvarësisht kësaj ata rekomandojnë se literatura përmban një sasi jo të mjaftueshme titujsh në literaturën mjekësore dhe duhet të pasurohet më tej me botime të fundit dhe me tituj të rinj.

GVB ju evidenton se literatura e fundit bashkëkohore mund të aksesohet online nga platformat u library dhe JSTORE pa pagesë nga të gjithë studentët dhe stafi akademik/ndihmës akademik nëpërmjet adresave të tyre personale në cdo moment dhe kudo përveçse shfrytëzimit të ambjenteve të dedikuara dhe të bollshme për studentët të bibliotekës së UE dhe FSHMT (ashtu sic është konstatuar edhe nga GVJ) të pajisur me poste pune dhe pajisje digjitale të duhura (EVIDENCA 3.7 Anëtarësimi ne JSTORE dhe U-Library).

Komenti i GVJ: GVJ pranon komentin e Institucionit dhe bën nryshimin përkatës.

4. Standardi IV.3/ Kriteri 7

Komenti i institucionit: GVJ rekomadon zgjatjen e mëtejshme të orarit të bibliotekës, me qëllim përmbushjen e nevojave të studentëve edhe jashtë orarit të studimit apo dhe në ditët e pushimit javor.

GVB pas konstatimit të rekomandimit të mësipërm evidenton faktin se kjo duhet të jetë lapsus teknik pasi biblioteka kryesore e UE është e hapur nga e hëna në të premte ora 08:00-19:00 dhe të shtunën nga ora 08:00-16⁰ (EVIDENCA 4.10 Te dhena mbi orarin e shërbimit te Bibliotekes

Komenti i GVJ: GVJ pranon komentin e Institucion dhe bën ndryshimin përkatës.

5. Standarti IV.3/ Kriteri 8

Komenti i institucionit: GVJ shkruan që nuk ka të dhëna konkrete në lidhje me shfrytëzimin e sallave të studimit apo të shfrytëzimit të literaturës on line, ndërkohë që deklarojnë që gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët, ata e shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme fondin e bibliotekës fizikisht dhe kryesisht atë on-line.

GVB gjykon se deklarimi në draft raport nuk është koherent me atë që është konstatuar në takimet fizike me stafin dhe studentët.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion, kriteri citon të dhëna konkrete, pra të dokumentura sic janë të dhënat statistikore. GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur ne RVJ.

Standardi IV.5 kriteri 2, 3

Komenti i institucionit: GVJ deklaron se nuk gjen të dhëna në lidhje përfitime financiare nga grande vendase apo të huaj, përfitime financiare si rezultat i shërbimeve ofruar palëve të treta, përfitime financiare nga projektet etj.

GVB evidenton se stafi akademik dhe studentet janë financuar për kërkimin shkencor nëpërmjet ogranizimit të projekteve shkencore si "Konferenca Ndërkombëtare Infermierore (e fundit u organizua ne 19 maj 2022, e 8-ta ne rradhe)" dhe Konferenca Nderkombetare Mjekesore" (e fundit 2019, e 10 ne rradhe) të përvitshme me publikimin e abstrakteve e artikujve shkencore ne "Book of Proceedings" përkatëse pa asnjë lloj pagese (bashkëlidhur këtij dokumenti gjeni evidencat publikimet me ISBN). Gjithashtu UE dhe FSHMT në të gjitha bashkëpunimet me institucione homologe në vend, në aktivitetet e bashkëorganizuara, kanë marrë pjesë gjithashtu në mënyrë aktive me punime shkencore dhe publikime pa pagesë (bashkëlidhur evidence librat e publikuar nga bashëpunimet). Stafi akademik dhe student botojnë dhe kanë akses pa pagesë në Buletinin shkencor të publikuar cdo vit nga UE me ISSN (bashkelidhur evidence Buietini UE). UE për të dytin vit rradhazi organizon Konferencen e dytë Ndërkombëtare Studentore" duke financuar publikimet e punimeve të studentëve në librin e abstrakteve/punimeve me ISBN (bashkelidhur libri i publikuar).

Gjithashtu Departamenti i Infermieristikes, ne vitin 2021 ka perfituar fondin nga AKKSHI per projektin "Ndikimi i COVID-19 ne organizimin dhe menaxhimin e sistemit shendetesor; implementimi i nje modeli epidemiologjik-matematikor" me fituese projekti pergjegjesen e departamentit Doc. PhD Elona Gaxhja (bashkelidhur "Shkrese nr 18057/1 Prot date 27/10/202" Ministria e Financave dhe Ekonomise). Ne vitin 2022 anetarja e departamentit Dr.Liljana Ramasaco dhe Doc.PhD Elona Gaxhja janë gjithashtu pjese e projektit "Vleresimi i shendetit mendor ne grupmoshat 15-24 vjec post Covid-19" me grant të fituar nga AKKSHI sërish. Departamenti referon se këtë vit (Prill 2023) janë aplikuar në AKKSHI dy projekte me drejtuese dy anëtarë të departamentit.

Komenti i GVJ: Vlerësimi i GVJ për këtë kriter është bazuar në dokumentacionin e hedhur në sistem para dhe pas vizitës në institucion. Theksojmë se komenti i mësipërm bazohet në dokumenta të hedhura në system pas dërgimit të raportit në Institucion.

GVJ pranon komentin e Institucion dhe bën ndryshimin përkatës.

Konkluzione për vlerësimin e standartit IV:

GVJ është dakort me vlerësimin perfundimtar "Plotësisht" të standartit IV dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në RVJ.

3. STANDARTI VI

Standarti VI.1/ Kriteri 1

Komenti i institucionit: GVJ konstaton që UNIEL nuk ka hartuar ende një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të

mësimdhënies. GVB ju ri-evidenton që për plotësimin e mësimdhënies me metoda inovative në bazë të fushës së studimeve përdoret laboratorit digjital i anatomisë, e përmendur kjo në evidencë (EVIDENCA 3.11 Shkrese e AKKSHI-t për krijimin e Laboratorit Digjital të Anatomisë, UNIEL). Gjithashtu përfshirja e studentëve në detyrat e kursit nga pedagogu i lëndës, e shprehur kjo edhe në syllabusin e lëndës me përqindje vlerësimi. (EVIDENCA 2.5 Programet lëndore të programit të studimit "Bachelor në Infermieri të përgjithshme"). Zhvillimi i praktikave të studentëve në ambientet spitalore, duke qënë prezente dhe aktive nëpërmjet metodave simulative gjithashtu përbën një nga metodat inovative të mësimdhënies në FSHMT (EVIDENCA 1.13 Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave).

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në RVJ. UNIEL nuk ka hartuar ende një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional.

Standarti VI.1/ Kriteri 2

Komenti i institucionit: GVJ deklaron që nuk evidentoi formë të tjera të drejtpërdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. Bazuar në dokumentacion dhe gjatë takimeve me përfaqësues të zyrave GVJ evidenton që sistemi i sigurimit të cilësisë funksionon në rang institucional dhe nuk ka njësi të vecanta në çdo njësi kryesore.

GVB raporton që vlerësimi i drejtpërdrejt i mësimdhënies nga njësi kryesore (FSHMT) bëhet duke vlerësuar syllabuset e lëndës, të dorëzuara dhe të miratuara në njësinë bazë dhe në atë kryesore, nga pedagogët përkatës e shprehur kjo edhe në rregulloren e brendshme të Fakultetit dhe Departamentit. (EVIDENCA 2.5 Programet lëndore të programit të studimit "Bachelor në Infermieri të përgjithshme"). (EVIDENCA 2.7 Rregullore e departamentit të Infermieristikës) (EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike). Njësia kryesore vihet në dijeni nga njësi bazë nëpërmjet analizës vjetore të dorëzuar çdo vit për rritjen akademike të stafit, ku përfshihen: organizimi i konferencave nga njësi bazë, nxitja e stafit akademik për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme dhe për marrjen e titujve shkencorë (departamenti i Infermieristikës ka aktualisht 5 staf akademik në proces doktorature) (EVIDENCA 1.14 Raporti vjetor (analiza vjetore) i Departamentit të Infermieristikës 2021-2022).

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në RVJ. Komentet e institucionit i vlerësojmë por kriteri citon kërkesën për vlerësimi të drejtpërdrejtë të mësimdhënies.

Standarti VI.I/ Kriteri 5

Komenti i institucionit: GVJ raporton që gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk gjen shembuj të promovimit të praktikave të mira me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mësimdhënies. GVJ vlerëson se të dhënat në raportin përfundimtar janë kryesisht përshkruese në terma sasiorë dhe jo analitike gjithashtu nuk evidentohet adresim i problematikave.

GVB raporton që institucioni, në vecanti NJSBC, vlerëson rezultatet e marra nga pyetësorët vlerësues të procesit të mësimdhënies nga studentët, raportin e analizës vjetore për fakultetin dhe universitetin etj, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it. Veprimtaritë, praktikat më të mira si: Leksionet e hapura, ëorkshop-et dhe aktivitete të tjera në shërbim të formimit të

studentëve, publikohen si modele dhe shembuj përfaqësues në këtë faqe zyrtare (EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).

Këto veprimtari janë të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të UE <https://eee.uni-el.edu.al/> si edhe në rrjete sociale zyrtare të UE. Adresimi i problematikave nga njësia bazë raportohen në njësinë kryesore dhe me pas në nivel.

Institucional (EVIDENCA 1.14 Raporti vjetor (analiza vjetore) i Departamentit të Infermieristikes 2021-2022) (EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).

Pranimi në fakultet i studenteve në programin e studimit Infermieri e Përgjithshme me një mesatare më të lartë se programet e tjera (EVIDENCA 2.28 Cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve të programit të studimit "Bachelor në Infermieri e përgjithshme")

Komenti i GVJ: GVJ pranon komentin e Institucion dhe bën ndryshimin përkatës.

Standarti VI.2/ Kriteri 4

Komenti i institucionit: GVJ deklaron se NJSBC përqipet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat sipas gjyqimit të GVJ, kanë nevojë të metejshme të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

Kështu GVJ evidenton se vlerësimet e kryera për mësimdhënien (referuar pyetësoreve për studentin dhe vlerësimin e pedagogëve), janë vetëm përshkruese jo analitike, rezultoni se pyetjet janë standarte pa përmbushje të qëllimit final të pyetësorëve.

GVB konsideron me vend rekomandimin e GVJ, pasi është raportuar që NJSBC e Fakultetit është një njësi e re, e sapo krijuar, e dokumentuar kjo edhe në RVB-në e dorëzuar. Kjo njësi është duke plotësuar dhe konsoliduar hartimin e një pyetësori në rang njësie kryesore dhe njësie baze.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në RVJ.

Standarti VI.3/ Kriteri 1

Komenti i institucionit: GVJ deklaron se nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishikimit me qëllim përmirësimin në këtë program studimi.

GVB raporton që NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar hartimin e një pyetësori në rang njësie kryesore dhe njësie bazë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe hartimin e një plani të mirefillte duke u bazuar në përmirësimin e problematikave që do të evidentohen.

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur në RVJ. GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishikimit me qëllim përmirësimin në këtë program studimi.

Standarti VI.5/Kriteri 3,4,5

Komenti i institucionit: GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Keto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojne përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

GVB raporton që problematikat e adresuara nga raporti i UE mbi pyetësorin e administruar të studentëve, janë marrë në konsideratë për tu përmirësuar sipas strategjisë afatgjate të FSHMT dhe Departamentit të Infermieristikes.

GVB ju vendos ne dispozicion evidencat:

(EVIDENCA 2.16 Strategjia e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike) (EVIDENCA 2.6 Strategjia e Departamentit të Infermieristikes)

GVJ deklaron se nuk identifikoi veprimtari dhe informacione qe lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentet për informimin dhe ndergjegjesimin e tyre per sigurimin dhe permiresimin e afatgjate të cilësisë së programit të studimit. Për sa më sipër GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e eficencës së aktiviteteve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndergjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

GVB raporton që pjesëmarrja e studenteve në trajnime, veprimtari kërkimore e shkencore, konferenca studentore, takimet me perfaqësues te ASCAL-it etj., mundeson informimin dhe ndergjegjesimin e tyre per sigurimin dhe permiresimin afatgjate te cilesise se programeve te studimit te FSHMT-se dhe ne ve;:anti te Departamentit te Infermieristikes. Keto veprimtari janë të pasqyruara ne faqen zyrtare te UE <https://www.uniel.edu.al/>

Komenti i GVJ: Vlerësimi për këtë kriter është bazuar në dokumentacion dhe GVJ i qëndron konstatimit të paraqitur ne RVJ. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte pershkruese jo analitike.

Konkluzione mbi standartin VI:

GVJ i qëndron vlerësimin perfundimtar të Standartit VI si i permbushur "Kryesisht".

Bazuar në konstatimet dhe evidencat e sipër permendura GVJ gjykon të drejtë se vlerësimi perfundimtar duhet të jetë "Plotësisht"

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (UNIEL), është një institucion publik i arsimit të lartë i i Liçencuar me VKM 414, datë 03 .12.1991 të Ministrisë së Arsimit i cili miratoi kthimin e Institutit të Lartë pedagogjik në UNIEL. UNIEL është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 49, date 27.11.2020. Në përberje të tij janë pesë fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, natyrës, edukimit, humane dhe mjekësore. Programet që ofron institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit vëndit në përputhje me profilin e institucionit (Statuti UNIEL). Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin UNIEL si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave mjekësore Teknike. (Evidenca 1.1. Statusi i UNIEL dhe Evidenca 7. Regullorja FSHMT).
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi bachelor Infermieri e Përgjithshme zhvillohet në Departamentin e Infermieristikës pranë FSHMT. Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se programi Bsc në Infermieri e Përgjithshme (IP) është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UNIEL dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL (Evidenca 1.1. Statusi i UNIEL dhe Evidenca 7. Regullorja FSHMT, evidenca1.8 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Infermieri të përgjithshme).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor ne “Infermieri e përgjithshme” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UNIEL 2020-2024, Rregulloren e Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. (Evidenca 1.1. Statusi i UNIEL dhe Evidenca 7. Regullorja FSHMT, evidenca1.8 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Infermieri të përgjithshme).
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programit të studimit të ciklit të parë në Infermieri të Përgjithshme (UNIEL është Liçencuar me VKM 414, datë 03 .12.1991 të Ministrisë së Arsimit dhe Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” është hapur me Urdhër Nr Prot. 2273, date 05/06/2001 të MASH pranë departamentit të Infermierisë) çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të

	<p>kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademike dhe mbështetës.</p> <p>(vizita e ambienteve, Evidenca 1.1. Statusi i UNIEL dhe Evidenca 7. Regullorja FSHMT, evidenca1.8 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Infermieri të përgjithshme).</p> <p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit [takimi me stafin drejtues, stafin akademik dhe mbështetës, vizita në ambientet e UNIEL].</p> <p>GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore (laboratorin dixhital të anatomisë humane, laboratorin biokimik klinik, Laboratorët e procedurave infermierisike, manikina pediatrike dhe adulte për kryerjen e procedurave infermiere, manikina simulatore në dispozicion të studentëve të gjithë programeve të studimit në infermieri), të cilat ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët.</p> <p>Në dispozicion të studenteve të programit studimit Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme janë dhe Laboratorët në varësi të departanenteve të tjera të FSHMT. GVJ evidentoi se institucioni ka kapaciteteve akademike të mjaftueshme për realizimin e programeve të studimit ku shumica e lëndëve/ moduleve mbi 80% e ngarkesës mësimore mbulohe nga stafi akademik efektiv. FSHMT ka staf akademik efektiv në fushën e mjekësisë dhe infermierisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Për realizimin praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UNIEL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike të qarkut të Elbasanit si spitali rajonal Elbasan, Spitali Psikiatrik "Dr.Sadik Dinçi", Elbasan, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Elbasan. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se ka përfunduar afati ligjor i marrëveshjeve dhe duhet të rinovohen.</i></p> <p><i>Rekomandim: GVJ rekomandon rinovimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis UNIEL dhe institucioneve shëndetësore.</i></p> <p>(evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikës, evidenca.4 Plani mësimor, evidenca 2.15 Plani i ngarkesës mësimore).</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>FSHMT përbëhet nga katër departamente: Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore.</p> <p>FSHMT në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë:</p> <p>I.Programe në ciklin e parë bachelor gjashtë</p> <ol style="list-style-type: none"> Bachelor në “Infermieri përgjithshme”; Bachelor në “Infermieri mami” Bachelor teknik laborator Bachelor fizioterapi Bachelor teknik imazherie Logopedi <p>II. Programe në ciklin Master shkencorë, 2(dy).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 13

	<p>a) Master shkencor në Infermieri</p> <p>b) Master shkenocr mami</p> <p>III. Programe ne master profesional 6(gjashtë)</p> <p>a) MP në teknik imazherie.</p> <p>b) MP në teknik laborator .</p> <p>c) MP në logopedi.</p> <p>d) Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale.</p> <p>e) Master Profesional në Menaxhim Infermieror.</p> <p>f) Master Profesional në Fizioterapi</p> <p>IV Program doktorature , 1(një)</p> <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore. Klasifikimi/ kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL. (Evidenca 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit. evidenca1.2 Regullorja e FSHMT).</p>								
Konkluzione	<p>-Programi Bsc në Infermieri e përgjithshme (IP) është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UNIEL, fushës akademike dhe veprimtarisë së FSHMT dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</p> <p>-FSHMT përbëhet nga katër departamente: Departamenti i Infemieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore dhe në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>-Institucioni ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikës mësimore si laboratorin dixhital të anatomisë humane, laboratorin biokimik klinik, Laboratorët e procedurave infermierisike, manikina pediatrike dhe adulte për kryerjen e procedurave infermierore, manikina simulatore), të cilat ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët.</p> <p>-Institucioni ka kapaciteteve akademike të mjaftueshme për realizimin e programeve të studimit ku shumica e lëndëve/ moduleve mbulohen kryesisht nga stafi akademik efektiv.</p> <p>-FSHP ka staf akademik efektiv në fushën e mjekësisë dhe infermierisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti i SHMT është pjesë e UNIEL. FSHMT ofron 15 programe studimi ku përfshihet dhe programi i studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme. Në këtë program studimi në të tre vitet akademike janë mbi 700 studentë. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Sikundër u theksua gjatë takimit me drejtues të fakultetit dhe departamentit në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi ngushtë që egziston midis departamenteve të FSHMT dhe stafit akademik respektiv. Bashkëpunimi dhe detyrat brënda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSHMT dhe departamentit të infermierisë ku realizohet programi i studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme dhe analizohen çdo vit akademik në raportin vjetor të analizës së veprimtarisë së departamentit.</p> <p>Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësues, projekteve, hartimin e buxhetit, rekrutim stafi akademik etj funksionojnë ngritja e grupeve “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik të departamentit të infermierisë ose të departamenteve të tjera të FSHMT. Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njërive bazë të FSHMT apo departamenteve të lendëve jo mjekësore si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi.</p> <p>(Evidenca 7. Rregullorja FSHMT, evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Infermieri të përgjithshme. Takimi me drejtuesit. Evidenca 1.14 Raporti vjetor Departamenti i Infermieristikes.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe shëndetësore brënda dhe jashtë vëndit. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me spitalin Rajonal Elbasan, Spitalin Psiquatrik Sadik Dimci Operatori i shërbimit të kujdesit shëndetësor etj që ndihmojnë studentët të zhvillojnë praktikën profesionale, realizimin e temave të dilomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimin e kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë. UNIVEL dhe FSHMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunim me Urdhërin e Infermierit për marjen e të dhënave lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në FSHMT apo nevojat e tregut të punës, Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, International University of Struga Staffordshire University, Skoci Aristotle University of Thessaloniki Aristotle University of Thessaloniki etj si dhe një sërë institucione të arsimit të lartë brënda dhe jashtë vëndit, Projekte bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentë në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projekte ndërkombëtare.</p> <p>(Evidenca 1.3 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit ERASMUS) në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni</p>	<p>Për realizimin e këtij program studimi, FSHMT dhe departamenti Infermieristikës, në fillim të vitit akademik për mbikëqyrjen dhe</p>

<p>nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>koordinimin e realizimit të praktikës profesionale, temave të diplomës, caktojnë koordinatorët e praktikës dhe institucionit ku realizohet praktika apo aktivitet e tjera si Spitali Rajonal Elbasan Qendra Gratë në Shërbimin Publik Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor etj [evidenaca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave, Evidenca 2.11 Dosja e praktikës BA Infermieri e pergjithshme.).</p> <p><i>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konsiston se janë paraqitur vetëm lista e marveshjevet e bashkëpunimit dhe mungon dokumentacioni fizik i marëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet shëndetësore dhe IAL të tjera. Një pjesë e marrëveshjeve duhet të rinovohen sepse ju ka mbaruar afati i bashkëpunimit.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Infermieristikës si njësia bazë ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike analizon përfitimet nga marveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bsc. në Infermieri të Përgjithshme si ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e aktiviteteve të përbashka me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e projekteve të ndryshme apo mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve. Të dhënat analizohen në analizën vjetore të departamentit</p> <p>(Evidenca 1.14 Raporti vjetor Departamenti i Infermieristikës).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon.</p> <p>Në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi ngushtë që egziston midis departamenteve të FSHMT dhe stafit akademik si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të UNIEL dhe FSHMT me institucionet arsimore dhe shëndetësore brenda dhe jashtë vendit. Insitucioni ka marrëveshje bashkëpunimit me institucionet shëndetësore dhe IAL të tjera por një pjesë e tyre ju ka përfundura afati ligjor i bashkëpunimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
--	--	-------------------------------------	------------------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” është hapur për herë të parë me Urdhër Nr Prot. 2273, date 05/06/2001 të MASH, si kurs studimi, pranë Departamentit të Biologjisë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkëputje nga puna me kohëzgjatje 3 .5 vite akademike. Më vonë program u organizua sipas sistemit të Bolonjës dhe në vitin 2008-2009 u emërtua “Bachelor në Infermieri të përgjithshme”.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermieristikës, FSHMT sipas nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 180 ECTS, kohëzgjatje 3 vite akademike, të ndarë në dy semestra për çdo vit akademik , në total 6 semestra, të ndara në lëndë/ module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 të MASR datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në total programi ka 4500 orë prej të cilave 47% janë jashtë auditorit.</p> <p>Studimet përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor në infermieri e përgjithshme"</p> <p>[evidenca 7. Regullorja FSHMT, Evidenca 1.8 RRegullore e programit të studimit BA Infermieri e përgjithshme. Evidenca 2.4 programi mesimor në programin e studimit Bsc Infermieri përgjithshme].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Infermieri e përgjithshme” ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni të Arsimit të lartë UNIEL. Programi i studimit synon rritjen e kapaciteve profesionale të studentëve në fushën e infermieristikës dhe siguron informacionin bazë për përgatitjen e infermierit të përgjithshëm me formim të plotë dhe të gjithanshëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor bazë për çdo patologji dhe grup moshë. Njohuritë e fituara në këtë program studimi gjatë orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale në institucionet shëndetësore me të cilat institucioni ka marrveshje bashkëpunimi, ju shërbejnë studentëve për përfundimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për ti shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale si dhe zgjidhjen e situatave komplekse. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, studentët kanë fituar njohuritë dhe kapacitet e nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë. [evidenca 2.4 programi mesimor në programin e studimit Bsc Infermieri përgjithshme Takimi me studentët] .</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Infermieri e përgjithshme” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM</p>

<p>grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në :</p> <p>A. Lëndë bazë 25 ETC(14%)</p> <p>B. Lëndë karakterizuese 95 ETC(53%)</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 15 ETC (7%)</p> <p>D. Lëndë plotësuese 29 ETC (16%)</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse 18 ETC (10 %)</p> <p><i>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ETC/ përqindje nuk përputhet me ato të parashikuar në VKM “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë si : Lëndët plotësuese përbëjnë 16 % nga 10-15% të parashikuar në VKM përkatëse, Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 15 % nga 12-15% të parashikuar dhe Lëndë bazë 14% nga 15%-20% parashikuar.</i></p> <p><i>Rekomandim: Rishikimin e planit mësimor sipas VKM nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</i></p> <p>(Evidence shtesë : Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në programin e studimit një vend të vecantë zë dhe praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Praktika profesionale ka 32 ETC/ 800 orë mësimore dhe detyrimet përmbyllëse 6 ETC/ 150-orë mësimore.</p> <p>(Evidenca shtesë. Plani mësimorë)</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi i FSHMT të UNIEL bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Forma e studimeve në FSHMT është studime me kohë të plotë. Pranimi i studentëve bëhet nga matura shtetëore sipas kriterëve të miratuar nga MASH. Programet e studimeve të ofruar nga FSHMT organizohen në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga studenti është 60 kredite. Programet e studimeve organizohen në tre cikle: cikli i parë, cikli i dytë dhe i tretë. Programi Bsc IP është i organizuar me kohë të plotë në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, me 60 ETC për çdo vit akademik në total 180 ETC,(2410 orë mësimore në auditor dhe 2090 jashtë auditorit) nga të cilat praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar i shkojnë 38 kredite. Ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë. Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar nga Dekanati FSHMT. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, projekte/ detyra kursi, praktikë mësimore/ profesionale. Në të tre vitet, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve shëndetësore me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje</p>

	<p>bashkëpunimi. Praktika profesionale është 32 ECTS /800 orë. Ajo mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizimin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Neni 59 pika 8. GVJ shqyrtoi dokumentin lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019- 2020-2021-2022 të miratuar me vendim të senati. Ngarkesa mësimore përcaktohet në orët mësimore në auditor dhe përfshirja në aktivitete të tjera në dobi të fakultetit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se <i>ngarkesa mësimore e pedagogëve është më e madhe se normat e përcaktuara nga MASH dhe ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë.</i></p> <p><i>Rekomandim: GVJ rekomandon rishikimi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore stafit akademik.</i></p> <p>(Evidenca shtesë. Plani mësimor, Evidenca 1.7 rregullorja e FSHMT]. 2.11 Dosja e praktikës BA Infermieri e përgjithshme. Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Bsc IP. Evidenca 1.12 lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Evidenca 2.26 Ngarkesa mësimore e pedagogëve).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor ne Infermieri e përgjithshme" ne UNIEL, ka nje ngjashmëri në masen 70% me programe në fushë të ngjashme studimi, cikël dhe të njëjtën emërtesë si programe Bachelor në Infermieri të përgjithshme te ofruara nga Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlores, Universiteti Gjirokastër, Universiteti Shkodrës.</p> <p>(Takimi me stafin drejtues te FSHMT)</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në Infermieri e Përgjithshëm, i ofruar nga FSHMT ka kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimi të miratuar nga Ministrisa Arsimit dhe Shkencës, me shkresën nr prot 604/1 datë 11.05.2018.</p> <p>(Evidenca 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit FSHE).</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>FSHMT nuk ka programe studimi të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>-Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Infermierisë FSHMT sipas nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe organizohet në 180 ECTS, kohëzgjatje 3 vite akademike, të ndarë në dy semestra për çdo vit akademik. Në total programi ka 4500 orë prej të cilave 47% janë jashtë auditorit. Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor në infermieri të përgjithshme".</p>

	<p>- Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” ku veprimtaritë formuese janë të grupuar në kategori A,B,C,D,E por GVJ konstaton se shpërndarja e ETC sipas kategorive nuk përputhet me ato të VKM.</p> <p>- Ngarkesa mësimore e pedagogëve është më e madhe se normat e përcaktuara nga MASH dhe ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë.</p> <p>-Programi i studimit Bsc në IP në UNIEL, ka një ngjashmëri në masen 70% me programe në fushë të ngjashme studimi, cikël dhe të njëjtën emërtesë me programe në IAL të tjera Kombëtare.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Ky program studimi realizohet pranë departamentit të Infermieristikës. Struktura organizative e departamentit/ programit përbëhet nga stafi akademik dhe ndihmës (sekretaria departamentit, personeli mbështetës për laboratorët). Programi i studimit Bachelor “Infermieri e përgjithshme” është hapur për herë të parë me Urdhër Nr Prot. 2273, date 05/06/2001 të MASH, si kurs studimi, pranë Departamentit të Biologjisë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me shkëputje nga puna me kohëzgjatje 3 .5 vite akademike. Më vonë program u organizua sipas sistemit të Bolonjës dhe në vitin 2008-2009 u emërtua “Bachelor në Infermieri e përgjithshme”. Në vitin 2012 me hapjen e FSHMT Programi Bsc në Infermieri e Përgjithshme bëhet pjesë e FSHMT dhe zhvillohet pranë Departamentit të Infermieristikës. Departamenti i Infermieristikës mbulon dy programe studimi: Bachelor Infermieri e përgjithshme dhe Bachelor Infermieri-Mani me kohe e plotë.</p> <p>(Evidenca 2.26 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, Tabelat përmbledhëse)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi Bsc në Infermieri e Përgjithshme zhvillohet në Departamentit e Infermieristikës pranë FSHMT. FSHMT është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë” dhe përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura akademike: Asambleja e personelit akademik, dekanati, dekani dhe zv dekanet, drejtuesit e njësive bazë. - Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ: sekretar dekani, kryesekretare, sekretare. -Struktura ndihmësakademike me karakter mësimor- laborantët, për realizimin e praktikave mësimore laboratorike, praktika profesionale. Stafi ndihmës akademik asiston pedagogët për realizimin e programit mësimor. Në përberje të tij janë katër njësi bazë: Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike,

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 20

	<p>Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore dhe laboratorët mësimore si njësi ndihmëse. FSHMT ofron në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>(Evidenca 2.26 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, Tabelat përmbledhëse)</p>						
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Drejtuksi i njësisë bazë mbikqyr dhe koordinon aktivitetin mësimdhënës dhe kërkimor shkencor në departament dhe cakton koordinorin e programit të studimit. Koordinatori i programit përzgjidhet nga personeli akademik i programit përkatës dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor". Programi Bsc në IP ka Koordinatorin akademik i cili bën ndarjen e punës për koordinorët që ndjekin praktikën profesionale në strukturat shëndetësore ku realizohet praktika profesionale. Koordinatorin e programit ndjek ecurinë e regjistrimeve dhe transferimeve të studenteve, monitoron realizimin e projekteve e kompetenca e detyra të tjera. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit.</p> <p>(Evidenca 1.8 Regullore e programit të studimit BA Infermieri e përgjithshme, Evidenca 2.18 Vendim për caktimin e koordinorit të programit të studimit "Bachelor në Infermieri e Përgjithshme")</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>-Programi i studimit Bsc në infermieri e përgjithshme realizohet pranë Departamentit të Infermieristikës.</p> <p>-Struktura organizative e departamentit përbëhet nga stafi akademik dhe ndihmës akademik si dhe Koordinatorin akademik i programit. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit.</p> <p>- Koordinatorin e programit përzgjidhet nga personeli akademik i programit përkatës dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor".</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit e vënë në dispozicion si dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion konstaton se departamenti zotëro, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, syllabuset, literaturën e nevojshme, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore.</p> <p>[evidenca 2.4 programi i studimit bsc infermieri & evidenca 1.8 Regullorja e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Infermieristikës ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me planin mësimor të programit, ngarkesën mësimorë, ndarjen në leksione, seminare,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 21

<p>nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>praktika mësimore dhe profesionale si dhe ETC përkatëse për çdo lëndë, orarin e mësimor dhe auditorin ku kryhet lënda përkatëse, ndarjen e orëve sipas semestrave, orët brenda dhe jashtë auditorit të ndarë sipas viteve akademike, rregullat lidhur me frekuentimin e programit ku leksionet dhe seminarët janë të detyrueshme të frekuentohen në masën 80%, ndërsa laboratorët, praktika profesionale/ mësimore/ spitalore në masën 100%, mënyra e vlerësimit të studentit, realizimin e provimeve, praktikës profesionale etj [Evidenca shitesë. Plani mësimor, orari i realizimit të ngarkesës mësimore, evidenca 1.8 Rregullorja e programit].</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM. [evidenca 1.7 Rregullorja e FSHMT& DI, takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit i ofruara nga Departamenti i Infermieristikës përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin bsc në infermië të përgjithshme. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/ profesionale, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. [programi studimit, syllabuset]. Programi ka rregulore dhe dosjen për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse praktika profesionale është 240 orë në vit/10 ETC në vitin e parë dhe të tretët dhe 12 ETC/300 orë mësimore në vitin e dytë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton : - syllabuset janë organizuar/ formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. - Titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor në të gjitha syllabuset, referuar Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 58 “Statusi i personelit akademik”. Në takimin me drejtues të FSHMT dhe stafin akademik u diskutua ky shqetësim dhe kjo lidhej me shkaqe objektive si pezullimi i promovimit të titujve akademik për një kohë të gjatë nga MARS. Me rifillimin e procedurave për promovimin e titujve akademik ky problem do marrë zgjidhje. Rekomandim: Rishikimin e titullarëve të lëndëve të cilët duhet të jenë profesorë. (Evidenca shitesë: Plani mësimor. Evidenca 2.5 Syllabus BA Infermieri e përgjithshme).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Infermieri e Përgjithshme janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të cilat propozohen nga departamenti</p>

dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>përkatës. Përmirosimet orientohen drejt përmbajtjes, literaturës, metodologjisë etj, duke sugjeruar ndryshime në funksion të përmirësimit të tyre apo përshtatjeve me ndryshimet ligjore. Të gjitha ndryshimet e nevojshme të rishikuara, diskutohen dhe miratohen në department. Ndryshimet e propozuara kalojnë për miratim në Senatën Akademik (sipas nenit 38, pika I/dh) dhe i përcillen për njoftim MASR, ku nuk e kalojnë 20% të masës së ndryshimeve në program.</p> <p>(Evidenca 2.25 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit "Bachelor në Infermieri e Përgjithshme" & Evidenca I.14 Raporti vjetor (analiza vjetore) i Departamentit të Infermieristikës 202 I -2022)</p>		
Konkluzione	<p>-Departamenti i infermierisë ku realizohet programi i studimit përmban informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën, përmbajtjen e programit të studimit, sylabuset, literaturën e nevojshme, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>-Sylabuset janë organizuar/ formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/ profesionale, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse.</p> <p>- Titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor në të gjitha sylabuset.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës mësimore në laboratorët didaktikë dhe praktikës profesionale pranë shërbimeve klinike përbëjnë 37 % të orëve në auditor. [evidenca 1.8 Rregullorja e programit & plani mësimor]
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 23

<p>të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/ orë mësimore përputhet me profilin Bsc në “Infermieri e Përgjithshme”. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit të përgjithshëm dhe bazë në infermieristikë. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të formimit profesional sipas specialiteve. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional.</p> <p>[Evidenca 1.8 Programi i studimit Bsc IP. Evidenca shtesë. Plani mësimor. Takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se Struktura e programit Bsc IP, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare (ndryshime të vogla ka vetëm në numrin e ECTS për lëndë) dhe ka një ngjashmëri në masën 70% me programe në fushë të ngjashme studimi në IAL Kombëtare. Kjo vërehet në njehsimin e diplomave dhe planit mësimor që bëjnë studentet e këtij Universiteti, të cilët punojnë në vende të ndryshme të botës.</p> <p>(Takimi me stafin drejtues dhe stafin akademik, RVB).</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brenda dhe jashtë vëndit. Përditësimi i vazhdueshëm i programit me qëllim formimin profesional të infermierit, licensimin dhe punësimin në tregun e punës ka ndihmuar në njohjen e programit në vende të BE, USA Canada dhe integrim në tregun europian. Në takimin me pedagogë dhe studentë u referua se një numër studentësh të këtij programi kanë kryer motilitet në programet erasmus dhe u janë njohur të gjitha ETC e fituara në universitetet pritëse.</p> <p>[evidenca 1.8 Programi mësimor në Bachelor në Infermieri të Përgjithshme, tabelat e transferime nga/në FSHMT, procedura e njohjes së krediteve në kuadër të mobiliteti nga programet erasmus, raportet e urdhërit të infermierit mbi punësimet në tregun vëndas dhe të huaj].</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet elëndëve/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>FSHMT dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo syllabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Departamenti ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve të UNIEL apo UMT, cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës. Tekset mësimorë për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjëndet në fund të çdo syllabusi. Literatura e detyruar në fund të çdo syllabusi si tekset mësimore nuk kanë datën e botimit. Gjithashtu dhe literatura e rekomanduar nuk ka datë botimi.</p>

	<p><i>Rekomandim: GVJ rekomandon që literatura baze e detyruar dhe ajo ndihmëse të jetë e viteve të fundit. Të publikohet data e botimit të teksteve mësimore dhe literaturës ndihmëse.</i></p> <p>(Evidenca 2.5 Syllabus BA Infermieri e përgjithshme).</p>			
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit ju siguron studentëve njohuri bazë dhe specifike në këtë fushë si dhe ju shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës, aftësimin profesional teorik dhe praktik.</p> <p>(Evidenca 2.4 Plani mesimor i programit të studimit "Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme", Evidenca 2.5 Progranet lendore te programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme").</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Gjatë viteve të studimit studentet pajisen me njohuritë e nevojshme në fushën e infermieristikës, që i mundëson studenteve të vijojnë më tej në ciklin e dytë të studimeve në MP dhe MSH, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushat përkatëse dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>(Evidenca 2.5 Progranet lendore te programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme").</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>-Programi BSC Infermieri i përgjithshëm ju shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. -Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës mësimore në laboratorët didaktikë dhe praktikës profesionale pranë shërbimeve klinike përbëjnë 37 % të orëve në auditor.</p> <p>- Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin Bsc në "Infermier i Përgjithshme".</p> <p>-Struktura e programit Bsc IP, ka një ngjashmëri në masën 70% me programe në fushë të ngjashme studimi në IAL Kombëtare.</p> <p>-Njohuritë e mara në këtë program studimi i mundëson studenteve të vijojnë më tej në ciklin e dytë të studimeve në MP dhe MSH, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushat përkatëse dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>- Literatura bazë e detyruar dhe ajo ndihmëse që gjendet në fund të çdo syllabusi nuk ka datën e publikimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më</p>	<p>Realizmi i programit bën të mundur përftimin e shprehive dhe aftësive të duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre. Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron</p>

<p>mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>studentëve informacionin e duhur për formimin e tyre profesional në ushtrimin e profesionit të infermierit në shërbime të ndryshme klinike dhe në çdo grup moshë, si dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucionet shëndetësore partnere. Përditësimi i programit të studimit dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës bazohet në debatin shkencor në nivel departamenti dhe ekspertizën e marrë nga profesore të Departamentit, të profesoreve të ftuar nga Universitete Europiane por edhe Shqiptare. Qëllimi i diskutimeve dhe konsultimi me aktorët nga tregu i punës është përgatitja e profesionisteve të aftë dhe kompetencën e duhur, që bëjnë të mundur studentëve t'i përgjigjen nivelit bashkëkohor të sistemit shëndetësor kombëtarë dhe ndërkombëtar.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullorja programit, evidenca shtesë plani mësimor, orari mësimor].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura si Senatit akademik apo përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHMT për zgjidhje. Pyetsorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetsorë në mënyrë periodike, përfshihen në projekte dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHMT. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik.</p> <p>[evidencat e trajtimit të ankesave dhe procedura e vlerësimit dhe trajtimit të rekomandimeve të pyetsorëve, takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Përditësimi i programit të studimit bëhet me propozim të njësisë bazë ku realizohet ky program bazuar në propozimet me bazë shkencorë nga pedagogët që realizojnë programin e studimit bazuar në zhvillimet e fundit, përmirësimin e metodave të diagnostifikimit, zhvillimit të metodave të reja të teknikave infermiore në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p> <p>(Takimi me stafin akademik dhe RBV, Evidenca 1.14 analiza vjetore e DI).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>-Përditësimi i programit të studimit dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës bazohet në debatin shkencor në nivel departamenti dhe ekspertizën e marrë nga profesore të Departamentit, profesoreve të ftuar nga Universitete Europiane por edhe Shqiptare, në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>

	-Institucioni përdor një seri mekanizmash për përfshirjen e studentëve në procesin përmirësimit të programeve të studimit si Këshilli studentor, plotësimi i pyetësorëve apo pjesëmarrja e tyre në senatin akademik.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mesimdhënies, mesimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në realizimin e procesit mesimor programi Bsc në “Infermieri e përgjithshme”, përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Mësimi në auditor nëpërmjet Leksioneve, seminare, laboratore, seanca të praktikave profesionale (pjesa teorike) apo organizimi i seminare ose ëorkshope të cilat organizohen nga lëndë të vecanta ose departamenti -Mësimi i pavarur si : Detyra kursi, projekte, studim individual ,përgatitje për provime, përgatitje e tezes së diplomës, -Veprimtari të tjera, si praktika profesionale në klinika mjekësore apo qëndra shëndetësore. <p>(Takime me stafin akademik, evidenca 2.4 Plani mesimor i programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme", evidenca 2.5 Programet lendore te programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme, evidenca 1.8 Rregullore e programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme").</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mesimdhënies e mesimnxënies.</p>	<p>Gjatë mesimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mesimit apo praktikës mesimore dhe profesionale.</p> <p>(evidenca 1.8 Rregullore e programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të programit janë laboratorët mjekësorë të infermierisë dhe anatomisë digitale të nevojshem për zhvillimin e praktikave laboratorike mesimore. Materialet mesimore gjenden në formë fizike, si libra dhe dispenca leksionesh por dhe si literature elektronike që pedagogët i vënë në dispozicion përmes platformave të ndryshme, kryesisht email dhe sistemit teams i cili u përdor gjerësisht në vitet 2020 dhe 2020-2021 gjatë pandemisë së COVID -19, si metodë alternative e mesimdhënies/nxënies të cilat rezultuan relativisht efikase. FSHMT parashikon cdo vit një buxhet të veçantë për shtimin apo përmirësimin e metodave të mesimdhënies. Burime të tjera financimi përveç buxhetit nga UNIEL janë projektet e ndryshme të fituara si projekti me AKKSHI-n për infrastrukturën mesimdhënëse, projektet Erasmus për zhvillimin e kapaciteteve.</p> <p>(Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve FSHE. Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022.)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënien në</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincën mjekësorë apo petagogjike në lëndët që</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 28

<p>program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>zhvillojnë [CV e stafit akademik]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik dhe Planit mësimor GVJ konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. P.sh. mjek me formim në lëndët mjekësore klinike si mjek familje apo specilite të tjera zhvillojnë module në lëndë laboratorike specifike si mikrobiologji mjekësore, biokimi mjekësore, menaxhim laborator.</i> - <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë dhe ngarkesa mësimore e tyre është mbi normën e parashikua nga legjislacionit në fuqi.</i> - <i>Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, ku legjislacioni përcakton që lektorët duhet të jenë të zotërojnë gradën “Doktorë Shkencas”.</i> <p>Metodat e përdorura në funksion të secilës lëndë janë leksione me paraqitje me poëer point, shkrim në tabelë, fotoprojektorë, seminarët ku një rëndësi i jepet pjesmarjes së studenteve në diskutime interaktive apo në laboratorë ku studentë përfshihen në kryerjen vetë në mënyrë të pavarur të procedurave të ndryshme infermierore (praktika profesionale).</p> <p>Rekomandime</p> <ul style="list-style-type: none"> -<i>Të rishikohen ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e lëndëve që zhvillojnë pedagogët sipas formimit profesional që kanë.</i> -<i>Caktimi i titullarëve të lëndës pedagogë nga kategoria professor</i> -<i>Caktimi i lektoreve pedagogë që zotërojnë gradën Doktore e shkencave</i> <p>(Evidenca 2.15 Plani i ngarkesës mesimore DI. Evidenca 2.20 CV e personelit akademik BA Infermieri e pergjithshme. Evidenca 2.5 Syllabus BA Infermieri e pergjithshme).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Vlerësimi dhe përmirësimi në mënyrë periodike i formave dhe e metodat të mësimdhënies realizohet nga njësia bazë për zhvillimin e programit mësimor në bashkëpunim me NJSBC duke përfshirë në këtë proces studentet me qëllim reflektimin mendimeve dhe sugjerimet e tyre përmes përdorimit të pyetesoreve. Ky proces drejtohet dhe administrohet nga rektorati. Në mënyrë të vazhdueshme nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit monitorohet procesi i mësimdhënies duke ndjekur zhvillimin e leksioneve, seminareve, praktika mësimore në auditor nga drejtuesi i departamentit, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit si dhe intervistës individuale me secilin pedagogë të brëndshëm apo të ftuar lidhur me kryerjen nga pedagogu i të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur.</p> <p>Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. Çdo vit në analizën vjetore të departamentit paraqiten rezultatet e monitorimit të procesit të mësimdhënies nga drejtuesi DI dhe rekomandimet e NJSBC.</p> <p>(Evidenca 2.7 Regullorja e DI, takimi me stafin akademik, Evidenca 1.14 raporti vjetor i Departamentit).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel</p>	<p>Institucioni përdor mënyra të ndryshme për promovimin e shëmbujve dhe praktikave më të mira si trajnime të stafit akademik lidhur me përdorimin</p>

<p>institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>e metodave të reja të mësimdhënies si laborator digital, tabelat smartboard etj, përdorimin e teknologjisë në vlerësimin e performancës së studentëve , krijimin e mekanizmave bashkëkohorë për cilësinë e materialeve mësimore përdorur në IAL, rifreskim të njohurive lidhur me kërkesat dhe standartet e cilësisë. Institucioni ka realizuar trainime me anë të përfshirjes së stafit akademik në projekte të ndryshme për trajnime lidhur me metodat e mësimdhënies si programet Erasmus + KA 107 International Credit Mobility, Projekti Clean score(cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studentëve) etj. UNIEL ka ngritur një serë struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies si :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Strukturën ndihmes akademike që është përgjegjëse për koordinimin institucional, kërkimin shkencor dhe projektet. Struktura organizon aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen stafit akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. - Zyra e Buletinit Shkencor, për publikimin periodik të revistës. - Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET. - Njësia e sigurimit të brëndshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. <p>(Evidence 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve FE. Për mobilitetin e programet Erasmus + në universitetin Evidence 1.14 Raporti vjetor i Departamentit të Infermieristikës, evidenca 3.6 Marrëveshja për implementimin e CLEAN SCORE).</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> -Në realizimin e procesit mësimor programi Bsc në “Infermieri e përgjithshme”, përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si: Mësimi në auditor, Mësimi i pavarur si Veprimtari të tjera, si praktika profesionale në klinika mjekësore apo qendra shëndetësore. -Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. -Në funksion të programit janë laboratorët mjekësorë të infermierisë dhe anatomisë digitale të nevojshëm për zhvillimin e praktikave laboratorike mësimore. -Materialet mësimore gjenden në formë fizike, si libra dhe dispenca leksionesh por dhe si literature elektronike që pedagogët i vënë në dispozicion përmes platformave të ndryshme. -FSHMT parashikon çdo vit një buxhet të veçantë për shtimin apo përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Burime të tjera financimi përveç buxhetit nga UNIEL janë projektet e ndryshme si projekti me AKKSHI-n për infrastrukturën mësimdhënëse, projektet Erasmus, Clean Score për zhvillimin e kapaciteteve . - UNIEL ka ngritur një serë struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies si dhe ka realizuar trainime me anë të përfshirjes së stafit akademik në projekte të

	ndryshme . ---Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincën mjeksorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillojnë , por GVJ konstatoi ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional, një pedagog jep më shumë se tre lëndë dhe ngarkesa mësimore e PAE është mbi normën e parashikua nga legjislacionit në fuqi. Ka Lektorë pedagogje të kategorisë Msc, ku legjislacioni përcakton që lektorët duhet të jenë të zotërojnë gradën “Doktorë Shkencas”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjith bazën e nevojshme ligjorë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve te cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët qënë fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion në ëbsite e UNIVEL. [Evidenca 2.7 Rregulloret e departamenti. Evidenca 1.8 rregullorja e programit të studimit . Evidenca 3.13 rregullorja e diplomomit]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Studentët informohen nga titullari i lëndës/ modulit dhe pedagogu lëndës me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHMT si dhe rregulloren e programit të studimit Bsc në Infermieri e përgjithshme [Takimi me studentët. Evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit rregullorja e diplomimit].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit bëhet nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm që realizohet me anë të provime të ndërmjetme, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/ praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe firmoset nga drejtuesi i njësisë bazë para zhvillimit të provimit. Kohëzgjatja e provimit përcaktohet në rregulloren e programeve të studimit nga njësia bazë. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit te provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së programit të studimit/ rregullorja e departamentit. Njoftime te detajuara për lëndët dhe

	<p>provimet vendosen dhe në platformen EMS si edhe njoftohen direkt nga departamenti.</p> <p>(Evidenca 1.8 Rregullorja së programit të studimit. Evidenca 2.7 Rregullorja e departamentit)</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i DI, ku zhvillohet ky program studimi. Për këtë qëllim çdo vit departamenti mbledh kërkesat lidhur me metodat e mësimdhënies, i diskuton në departament dhe përcakton buxhetin e nevojshëm i cili i paraqitet strukturave drejtuese të FSHMT. Një vënd të rëndësishëm në përgatitjen e buxhetit zënë dhe propozimet e bëra nga studentët, këshilli studentorë si dhe rezultatet e pyetsorit të studentëve ku studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik [takimi me stafin akademik, studentët dhe grupin kërkimor shkencor].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të programit janë laboratorët mjekësorë të infermierisë dhe anatomisë digitale, manikina për kryerjen e manipulimeve infermiore, paisje mjekësore, të nevojshme për zhvillimin e praktikave laboratorike mësimore. FSHMT dhe DI çdo vit parashikojnë një buxhet të veçantë për shtimin apo përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Burime të tjera financimi përveç buxhetit nga UNIEL janë projektet e ndryshme të fituara si projekti me AKKSHI-n për infrastrukturën mësimdhënëse, projektet Erasmus për zhvillimin e kapaciteteve.</p> <p>Gjatë procesit mësimor, praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesore të shërbimit shëndetësor sidomos në specialitet që përputhen me këtë program studimi. Pedagogët përdorin metoda të ndryshme për të inkurajuar studentët të punojnë në mënyrë të pavarur si :</p> <ul style="list-style-type: none"> -kryerja në mënyrë të pavarur të procedurave të ndryshme gjatë orëve të praktikave mësimore apo laboratorike, - përgatitja e detyrave të kursit ku studentët paraqisin raste klinike të përgatituar vet në mënyrë të pavarur. - praktikimi i tyre në manikinat simulatore e cila ju sigurojnë studentëve vetbesimin në dijet e fituara, praktikimin e aftësive profesionale, marjen e vendime në realizimin apo zgjidhjen e procedurave të ndryshme infermiore pa ndikuar në jetën e pacientit. -organizmi i studentëve në grupe të vogla si dhe asistimi i tyre nga personeli ndimës akademik gjatë praktikës ç'ka ju mundëson studentëve të kryejnë vetë procedura infermiore gjatë praktikës. <p>[Takimi me stafin akademik dhe studentët, evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit].</p>

Konkluzione	<p>-Institucioni zotëron gjith bazën e nevojshme ligjorë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik</p> <p>-Studentët informohen nga titullari i lëndës/ modulit dhe pedagogu lëndës me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Njoftime të detajuara për lëndët dhe provimet vendosen dhe në platformen EMS si edhe njoftohen direkt nga departamenti.</p> <p>-Vlerësimi i studentit bëhet nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Njoftime të detajuara për lëndët dhe provimet vendosen dhe në platformen EMS si edhe njoftohen direkt nga departamenti.</p> <p>-Përmirësimi i metodave të mësimdhënies është një proces i vazhdueshëm që realizohet nga departamenti ku realizohet program i studimit. Një element i rëndësishëm është përfshirja e studentëve në këtë proces nëpërmjet propozimeve të tyre, këshillit studentor si dhe si dhe rezultatet e pyetësorit të studentëve ku studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik</p> <p>-Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.</p> <p>Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që student mer gjatë gjithë semestrit/ akademik si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Frekuentimi : pjesëmarrja dhe aktivizimi në leksione, seminare , praktikë profesionale . 5% b. Kontrolli i vazhdueshëm <ul style="list-style-type: none"> Dorezimi i detyrave/proiekteve 5 % Provimi i ndermietetem/ kolokium 10-20 % Provim përfundimtar 70-80 % <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në baze të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Kjo</p>





	<p>mënyrë e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ pedagogu.</p> <p>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme")</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në UNIEL zbatohet prej disa vitesh sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve në disa programe studimi, në sajë të projektit CLEAN SCORE të financuar nga AADF. Në këtë program studimi nuk përdoren sistemet elektronike të vlerësimit. Metoda e përdorur për realizimin e testeve është e bazuar në sekretimin të të dhënave të studentit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim ruajtjen e anonimatit të studentit. Ndërsa pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Tesimi i dijeve përfundimtar realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar programin. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar nga një komisioni i përbërë nga tre pedagogë. Ndërsa provimi me shkrim realizohet me praninë e së paku të dy pedagogëve në varësi të numrit të studentëve dhe sallës në dispozicion. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrolllohet nga titullari i lëndës dhe miartohet nga përgjegjësi i departamentit. Sekretaria mësimore nxjerr frekuentimin e leksioneve, seminare dhe praktikave të studentit si dhe konfirmon realizimin e pagesave që ka detyrim studentit përpra se ai të hyjë në provim. Proçes verbal i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/ kordinatorit dhe komisionit të provimit.</p> <p>[Evidenca 2.7 rregullorja e departamentit. Evidenca 1.8 Rregullorja programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Testimi i dijeve kryhet me shkrim, në mënyrë anonime me sekretim sipas rregulloreve të Departamentit të Infermieristikës. Mënyra e testimit pasqyrohet në çdo sylabus lënde. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e aritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve të studentëve. Në këto seance pedagogu mundëson studentit nëse ky dëshiron, të shikoj rezultatet e provimit. Vlerësimi i çdo pyetje bëhet sipas shtimit të pikëzimit të cilat konvertohen në notë bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe të komunikuar në çdo sylabus.</p> <p>[Evidenca 2.7 rregullorja e departamentit. Evidenca 1.8 Rregullorja programit të studimit. 2.5 Syllabus BA Infermieri e përgjithshme.]</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse konstatohet kopjim në provim apo detyra kurs studentit i jepet vërejtje dhe i zerohet rezultati i provimit.</p> <p>(Evidenca 2.7 rregullorja e departamentit. Evidenca 1.8 Rregullorja programit të studimit).</p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyre konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin EMS. Nesë provimi realizohet me gojë rezultati meret menjëherë pas provimit. [Takimi me studentët].</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejte të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës të pedagogu i lëndës që ka korigjuar provimin. Nëse studenti nuk dakorohet me rezultatin e provimit dhe sqarimin nga pedagogu, paraqet ankesën me shkrim drejtuesit të departamentit i cili bën verifikimet e duhura dhe nëse nuk zgjidh ankesën vë në dijeni dekanin. Dekani ngre komision "ad hoc" për verifikimim e ankesës së studentit dhe bën verësimin e provimit. Nëse provimi është zhvilluar me gojë studenti përsërit provimin në pami të komisionit "ad hoc" duke tërhequr një teze të dytë. Vlerësimi në këtë provim mbetet vlerësimi përfundimtarë i studentit. Procesi i ankimit kryhet në përputhje me rregulloren e provimit dhe rregulloren e programit të studimit. Ndryshimi i rezultatatit të provimit pasqyrohet në proces verval të frimosur nga komisioni "ad hoc" dhe i bashkangjitet vlerësimit të komisionit të mëparshëm dhe sistemin EMS. E gjithë procedura e ankesës dhe rivlerësimi i studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore, dhe në zyrën e kryesekretarit.</p> <p>(Evidenca 1.7 Rregullorja e FSHMT. Evidenca 2.7 Rregullorja e departamentit. Evidenca 1.8 Rregullorja e programit mësimor]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>-Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në baze të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Kjo mënyrë e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndeve/moduleve nga titullari I lëndës/pedagogu.</p> <p>-Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit.</p> <p>- Korrigjimi i provimit dhe trajtimit të ankesave të studentëve bëhet sipas rregullores së ptoqramit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në IP është 3(tre) vite akademike, 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS është 25 orë mësimore punë të studentit. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Volumi që zënë orët e praktikës mesimore dhe profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohen gjatë manipulimeve në manikina apo paisje mjekësore që janë në dispozicion në studentevë në laboratorin mjekësor të infermierisë.</p> <p>(Evidenca 1.7 Rregullorja e FSHMT. Evidenca 2.7 Rregullorja e departamentit. Evidenca 1.8 Rregullorja e programit mësimor)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshme si gjuha e huaj, informatike, lëndët social dhe komunikimit .</p> <p>(Evidenca 1.8 Rregullorja e programit mësimor. Evidenca shtesë Plani mësimor).</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin.</p> <p>Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkues të studentët. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët.</p> <p>(Takimi me studentët dhe stafin akademik, 2.11 Dosja e praktikës BA Infermieri e përgjithshme).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për</p>	<p>Në programi Bsc në Infermieri të Përgjithshme janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie.</p> <p>Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit dhe për tu përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit/ legjislacionit për pranimin e përgjegjësive apo vendimeve individuale lidhur me gabime të mundshme në praktikë, raportimin dhe marrjen e masave korigjuese.</p> <p>Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor.</p> <p>Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve gjatë diskutimeve të rasteve klinike në seminare, praktikave mësimore dhe veçanërisht ato profesionale</p> <p>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Uiversitetit apo sallat e kompjuteravë dhe</p>

të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>asistencën nga stafi akademik. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme. Në kuadër të marrëveshjeve dhe projekteve të mobilitetit të studentëve që Univeristeti ka me IAL në vëndet e BE, student të bachelorit kanë shkuar në universitet në vende të ndryshme të Europës si Itali, Poloni, Bolu Abant Izzet Baysal University Turqi. Pjesë e programeve të mobilitetit kanë qënë dhe pedagogë për trainime apo realizimte PhD.</p> <p>[Takimi me studentët dhe staf akademik. Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve].</p>		
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, departamenti në bashkëpunim me departamentët e tjera të FSHMT si dhe mjekë nga institucione shëndetësore apo institucione arsimore vëndase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, tavolina të rumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesmarës në këto aktivitete janë dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve</p> <p>[Takimi me studentë dhe pedagogë, evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022].</p>		
Konkluzione	<p>-Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Volumi që zënë orët e praktikës mesimore dhe profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale.</p> <p>-Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithsmë si gjuha e huaj, informatike, lëndët social dhe komunikimit.</p> <p>-Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor.</p> <p>-Në kuadër të marrëveshjeve dhe projekteve të mobilitetit të studentëve që Univeristeti ka me IAL në vëndet e BE, student të bachelorit kanë shkuar në universitet në vende të ndryshme të Europës.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome Bsc infermieri e përgjithshme pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e departamentit të Infermierisë dhe të programit të studimit në të cilën përshkruhet qartë proçedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare punimin e diplomes që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e ka bërë atë publike. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës dhe formatit të saj.</p> <p>(Evidenca 3.10 Manual i Punimit te Diplomes, Evidenca 3.13 Rregullore e Diplomimit, rregullorja e DI dhe programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Fokusi i programit Bsc në IP, është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtarë ose në përgatitjen e një teme diplome. Pedagogët i orientojnë studentët dhe ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzojnë në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantim e materialit.</p> <p>(Evidenca 3.10 Manual i Punimit te Diplomes, Evidenca 3.13 Rregullore e Diplomimit, rregullorja e DI dhe programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Teza e provimit përmban pyetje shtjelluese dhe kuice.</p> <p>Komisioni i ngritur nga departamenti përgatit tezën përfundimtare bazuar në temat të paraqitura nga secili pedagog. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. Rezultatet e provimit të përgjithshëm përfundimtar u jepen studenteve në fund të cdo dite provimi. Vlerësimi përfundimtar i provimit të formimit pasqyrohen në proces verbalin përkatës dhe Sistemin e menaxhimit të të dhënave. Korrigjimi i provimit përfundimtar kryhet nga një komision vlerësimi të miratuar nga dekani i fakultetit. Proçes verbali përfundimtarë i rezultatit të provimeve firmoset nga komisioni i vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari.</p> <p>(Evidence 3.13 Rregullore Diplomimit, evidence 1.8 rregullorja e programit të studimit në programin bachelor ne infermieri e përgjithshme)].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Përpara përfundimit të studimeve departamenti përcakton lëndët e formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe me zgjedhje që do përfshihen në provim</p>

<p>diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>dhe titullari i lëndës përcakton temat që do përfshihen në provim të cilat do përbëjnë fondin e pyetjeve të provimit. Këto ju vihen në dispozicion studentëve në ëbsite e Universitetit afshohen në ambientet e departamentit. Studenti informohet për fondin e pyetjeve dhe mënyrën e vlerësimit dy muaj përpara përfundimit të semestrit. Temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës të cilat pasi miratohen në departament ju vihen në dispozicion studentëve. Studentët asistohen nga pedagogët udhëheqës së temës së diplomës gjatë hartimit dhe realizimit të studimit. (Evidence 3.13 Rregullore Diplomimit, evidence 1.8 rregullorja e programit të studimit në programin bachelor ne infermieri e përgjithshme).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Realizimi i temës së diplomës bazohet në rregulloren e departamentit "Manual i Punimit te Diplomes". Institucioni i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësore që realizohet studimi ose realizojnë pjesën eksperimentale në laboratorët e departamentit. Leja etike për realizimi e studimit jepet nga dekanati i FSHMT. (Evidenca 3.10 Manual i Punimit te Diplomes).</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtarë i provimit të diplomës apo temës bëhet me notë. Teza korigjohet nga komisioni vlerësimit i përbërë nga 3-5 vetë. Proçes verbali përfundimtarë frimoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara jurisë së komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Prezantimi i temës së diplomës është i hapur dhe koha e prezantimit është 30 minuta. Pas prezantimit paraqësin mendimin oponentët dhe udhëheqësi i studimit. Tema e dilomës vlerësohet me pikë individuale nga secili anëtar i komisionit dhe në fund llogaritet mesatarja aritmetike. Në përfundim të procesit të provimit, Kryetari i Komisionit të provimit hedh rezultatet e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Proçes verbali i gjeneruar nga sistemi EMS, nënshkruhet nga kryetari dhe nje anetar i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe dorëzohet në sekretari. (Evidenca 1.7 Rregulloren e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike, Evidenca I.8 Rregullore e programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Në përfundim të studimeve në këtë program, studentit pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Infermier e përgjithshme. Proçedura që ndiqet për tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit. Studenti paraqet kërkesën në sekretari, kryhen pagesë në bankë dhe tërheq dokumenta e programit të studimit në departament brënda 10 ditëve pas dorëzimit të</p>

	<p>pagesës. Tarifa e pagesës është e përcaktuar me vendim të senatit akademik.</p> <p>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike, Evidenca 2.10 Modeli i suplementit diplomes te programit te studimit "Bachelor në Infermieri e Pergjithshme". Evidenca 2.9 Model diplome)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretariatë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltarë i studentëve, regjistri i vlerësimit të mara nga studentët gatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe certifikatave.</p> <p>(Evidenca 1.7 Rrregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike, Evidenca 3.14 Funkcionet dhe kompetencat e sekretarise mesimore te FSHMT, Evidenca 2.10 Modeli i suplementit te diplomes se programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme", Evidenca 2.9 Model diplome).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>-Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome Bsc infermieri përgjithshëm pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final.</p> <p>-Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e departamentit të Infermierisë dhe të programit të studimit në të cilën përshkruhet qartë proçedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit.</p> <p>- Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajisjet dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Infermier e përgjishme. Proçedura që ndiqet për tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Departamenti përgjegjës i programit të studimit është Departamenti i Infermieristikës. Në tre vitet akademike 2021-2022 përbërja e stafit akademik është si vijon:</p> <p>Për vitin 2019-2020 stafi akademik përbëhet nga 56 (pesëdhjete e gjashtë) staf akademik, prej të cilëve 9 (nëntë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 47 (dyzete shtatë) PAK. Nga PAE 1(një) është Prof, 1(një) Docentë 5(pesë) Msc dhe 2 (dy) janë në process doktorature. <i>Në këtë vit akademik institucioni nuk ka plotësuar kushtet ligjore me të paktën 3 PAE me grada/ tituj akademik.</i></p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 3 (tre) doktore shkencash dhe 44 (dyzet e katër) janë Msc.</p> <p>Për vitin 2020-2021 stafi akademik përbëhet nga 72 (shtatëdhjetë e dy) staf akademik, prej të cilëve 11 (njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) PAK. Nga PAE 1 (një) është Prof, 2 (dy) doktorë shkencash, 2 (dy) docent dhe 6 (gjashtë) Msc.</p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 4 (katë) doktore shkencash dhe 58(pesëdhjete e tetë) janë Msc.</p> <p>Për vitin 2021-2022 stafi akademik përbëhet nga 72 (shtatëdhjetë e dy) staf akademik, prej të cilëve 11(njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) PAK. Nga PAE 1 (një) është Prof, 4 (katër) doktorë shkencash, 3 (tre) Msc dhe 3(tre) janë në process doktorature.</p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 1(një) porfesor, 3 (tre) doktore shkencash dhe 57(pesëdhjete e shtatë) janë Msc.</p> <p>Në përbërje të Departamentin është dhë një personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën Master i Shkencave.</p> <p>Në tre vitet e fundit (2019-2022) numri i stafit akademik në department ka qënë stabil.</p> <p>(Evidence 2.26 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve/Tabelat 6 - Cilesia e stafit mesimdhenes per programin e studimit. Tabela 7 - Te dhenat permbledhese te stafit akademik per "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme" Evidence 1.1 Statuti UNIEL. Evidence shtesë. Plani mësimor . Evidenca 2.10 CV personelit akademik të përfshirë në Departamentin e Infermierisë)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e programit Bsc në Infermieri e Përgjithshme , janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/ laborant me formimn e duhur profesional, cili është përgjegjës për organizmin e praktikavë laboratorike mësimore dhe asiston pedagogët në realizimn e tyre si dhe studentët në praktikimin e proçedurave të ndryshme laboratorike. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ,</p>

	<p>është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike 2019-2022.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit Bsc. Infermieri e Përgjithshme është:</p> <p>Për vitin 2019-2020 stafi akademik përbëhet nga 56 (pesëdhjete e gjashtë) staf akademik, prej të cilëve 9 (nëntë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 47 (dyzete shtatë) PAK. Nga PAE 1(një) është Prof, 1(një) Docentë 1(një), 5(pesë) janë Msc dhe 2(dy) janë në process doktorature.</p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 3(tre) doktore shkencash dhe 44(dyzetekatër) janë Msc</p> <p>Për vitin 2020-2021 stafi akademik përbëhet nga 72 (shtatëdhjetë e dy) staf akademik, prej të cilëve 11(njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) PAK. Nga PAE 1(një) është Prof, 4(katër) doktorë shkencash, 3(tre) Msc dhe 3(tre) janë në process doktorature.</p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 1(një) profesor, 3(tre) doktore shkencash dhe 57(pesëdhjeteeshtatë) janë Msc</p> <p>Për vitin 2021-2022 stafi akademik përbëhet nga 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) staf akademik, prej të cilëve 11(njëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) PAK. Nga PAE 1(një) është Prof, 2(dy) doktorë shkencash, 2(dy) docent dhe 6(gjashtë) Msc.</p> <p>Nga Stafi akademik PAK janë 4(katë) doktore shkencash dhe 54(pesëdhjete e katër) janë Msc.</p> <p>Stafi akademik ka formimin dhe edukimin e duhur profesional për realizimin e programit mësimor.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se ka pedagog që japin më shumë se tre lëndë, japin lëndë të tipologjive të ndryshme apo që nuk përputhen me formin tyre profesional/specialitetin. P.sh. mjek me formim në lëndët mjekësore klinike si mjek familje apo specilite të tjera zhvillojnë module në lëndë laboratorike specifike si mikrobiologji mjekësore, biokimi mjekësore, menaxhim laborator.</i></p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik konstatojmë se pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore mbi 80% realizohet nga stafi akademik efektiv.</p> <p>Mosha e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit është relativisht e re dhe pjesa më e madhe e stafit akademik është në grup moshën 36-56vjeç. GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme.</p> <p>(RVB, Evidenca 2.7 Rregullorja e DI, Evidenca 1.8 Rregullorja e programit Bsc.IP, Evidenca shtesë. Plani mësimore. Evidenca 2.20 CV stafit akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion e shqyrtuar në drejtorinë e burimeve njerëzore, Departamentit, ku zhvillohet program i studimit si dhe CV e stafit akademik konstatojmë se në tre vitet e fundit stafi akademik është stabil. Nga shqyrtimi</p>

<p>në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>me sondash i kontratave të punës konstaojmë se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Takimi me zyrën e burimeve njëzore. Evidenca shtesë. Plani mësimore)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë.</p> <p>Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UNIEL. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo te pjesëshme realizohen nga njesia bazë duke propozuar komisione Ad-hoc conform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore te UNIEL . Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi. Nga shyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar.</p> <p>Konkretisht ,dosja e stafit akademik përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit. 2. Librezën e punës 3. CV 4. Listë notash, Diplomë, Diplomë gjuhë të huaj, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor 5. Fotokopje ID 6. Procedurën e punësimit 7. Vlerësimin e fazës së konkursit <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UNIEL dhe kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e UNIEL dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kritere për rekrutimin e personelit.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit, dekanati i përcjellë në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e EEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit.</p>

	<p>Pas shpalljes së vëndit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurrimi kalon ne dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim në bazë të dosjes 2. Intervista gojore <p>Kur një dosje skualifikohet Drejtoria e Burimeve Njerezore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5 ditë duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Per çdo fazë vlerësimi pritet 5 ditë pas shpalljes së vlerësimit të ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet rektoratit, icili harton kontraten e punës në bazë të kodit të punës dhe legjilacionit në fuqi. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim, Institucioni realizon vlerësim të vazhdueshëm duke shfrytëzuar zhvillimin e pyetësorëve të studentëve dhe formularët e vetëvlerësimit.</p> <p>(EVIDENCA 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit te personelit akademik UNIEL); (EVIDENCA 4.3 Rregullore e modaliteteve te rekrutimit te personelit ndihmeskademik); (EVIDENCA 4.18 Komisione ad_hoc per rekrutim personel akademik me kohë të plotë); (EVIDENCA 4.19 Komisione ad_hoc për rekrutim personel akademik me kohë të pjesëshme); (EVIDENCA 3.12 Skedë vetëvlerësimit te pedagogut)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirembajtjen e laboratoreve (Laboratori Digjital i Antomise, Laboratori i procedurave infermieristike) të programit të studimit Bachelor në Infermieri e Pergjithshme.</p> <p>Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.</p> <p>Tabela 7 - Te dhenat permbledhese te stafit akademik per "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UNIEL, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Bsc Infermieri e përgjithshme”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerezore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semester si dhe dosjen personale për staf jo akademik. Në regjistrin themeltar të stafit hidhen të dhenat si : data e fillimit të punësimit, ndryshimet e vendit të punës nqs ka, deri në largimin dhe tërheqjen e librezës së punës nga individi.</p> <p>Çdo vit Zyra e burimeve Njerezore bën dhe përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka venë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Gjithashtu GVJ evidentoi që cdo fillim viti akademik , pedagoget hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit te ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi I</p>

	<p>Departamentit dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë.</p> <p>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL) (EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021 -2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse); (EVIDENCA 2.7 Rregullore e Departamentit të Infermieristikes)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHMT dhe UNIEL garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione. Konkretisht GVJ evidentoi që UNIEL ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe sic janë Qendra Spitalore Dr. Xh.K dhe Spitalit Psikiatrik , Urdhërin e Infermierit Rajonal. Konstatohet që këtyre marrëveshjeve i ka kaluar afati, GVJ rekomandon rinovimin dhe plotësimin e tyre.</p> <p>Marreveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studenteve të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Infermieri e Përgjithshme dhe gjithashtu realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Institucional dhe zbatohen nga njësia bazë.</p> <p>Praktika e detyrueshme, mbikëqyrjet bashkarisht nga mbikëqyresi në vendin e praktikës (një infermiere e dedikuar) dhe anëtarit i caktuar i stafit akademik i departamentit.</p> <p>(EVIDENCA 2.1 I Dosja e praktikës për programin e studimit "Bachelor në Infermieri; (Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave)</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave klinike që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjeve të lidhura. Personeli mbikëqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në programin e studimit "Bachelor në Infermieri e Përgjithshme" ndihmon studentet si në përmbushjen e detyrimeve/ raportit përfundimtar të praktikës gjithashtu dhe në vlerësimin e tyre. Personeli infermieror i cili ndjek praktikën profesionale në spital bashkëpunon ngushtë me stafin akademik të departamentit, sipas shërbimeve klinike përkatëse.</p> <p>(EVIDENCA 2.11 Dosja e praktikës për programin e studimit "Bachelor në Infermieri)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Për realizimin e programit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc.</p> <p>Konstatohet se pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore mbi 80% realizohet nga stafi akademik efektiv.</p> <p>GVJ kostatoi se ka pedagog që japin më shumë se tre lëndë, japin lëndë të tipologjive të ndryshme apo që nuk përputhen me formin tyre profesional/specialitetin.</p> <p>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve pedagogëve sipas formimit të tyre profesional dhe grupimi sipas tipologjive të ngjashme.</p>

	<p>GVJ konstatoi se UNIEL, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Bsc Infermieri e përgjithshme”.</p> <p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHMT dhe UNIEL garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione. GVJ konstaton <i>që këtyre marrëveshjeve i ka kaluar afati, dhe rekomandon rinovimin dhe plotësimin e tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në instucion GVJ u njoh më mjediset e UNIEL. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme. Njësia bazë ka në dispozicione mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, dhe pse numri i studenteve, grupeve mësimore është i madh. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme dhe moduleve përkatëse. Institucioni disponon salla leksionesh, seminare, laboratorë të infermieristikës sallën e stimulimeve me mulazhe. FSHMT është i konceptuar si një kampus pranë Spitalit Rajonal Xhaferr Kongoli, duke bërë të mundur lidhjen e drejtpërdrejtë të procesit teorik me atë praktik spitalor.</p> <p>(Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike); (Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratoreve të Fakultetit); (Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raport me numrin e posteve në sallë. Ambientet mësimore janë me sistem kondicionimi</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 46

<p>teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>ngrohje dhe ftohje. Ambientet e FSHMT kanë nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës on line në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksionin të programit janë në dispozicion mjete elektronike dhe teknologjise së informacionit, si kompjutera dhe videoprojektorë kryesisht në sallat e leksioneve. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. (vizita e ambienteve)</p>		
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>FSHMT zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Infermierise apo departamante të tjera të FSHMT. Laboratorët e procedurave infermierisike, Laboratori digjital i anatomisë janë të paisuar me infrastrukturë bashkëkohore për realizimin e praktikave mësimore si TV dhe videoregjistrues, manikina pediatrike dhe adulte për kryerjen e procedurave infermiore, manikina simulatore në dispozicion të studentëve të gjithë programeve të studimit në infermieri, këto laboratore luajnë një rol të rëndësishëm realizimin e objektivave formues të këtij programi mësimor. Në dispozicion të studenteve të programit studimit Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme janë dhe Laboratorët në varësi të departanenteve të tjera të FSHMT (Evidenca 4.7 Të dhena mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve te Fakultetit)</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit në Bachelor në Infermieri të Përgjithshme është laboratori i teknologjisë së Informacionit. Këto laboratorë janë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për zhvillimin e laboratorëve të modulit të Teknologji Komunikimi dhe Informacioni. (Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të FSHMT)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. FSHMT zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Infermierise apo departamante të tjera të FSHMT. Në funksion të programit të studimit në Bachelor në Infermieri të Përgjithshme është laboratori i teknologjisë së Informacionit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 47

<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse <i>pothuajse të mjaftueshme</i> në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. (EVIDENCA 3.8 Fondi i librit).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me Stafin Drejtues, u deklarua që që cdo fillim viti akademik titullari i lendes/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. <i>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar.</i> I njëjti fenomen u evidentua gjatë gjatë shqyrtimit të kurrikulave, GVJ evidentoi që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe shpesh hërë bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët.</p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogeve dhe stafit administrativit dhe drejtues të UNIEL , për rritjen e buxhetimit apo sigurimin e burimeve të tjera me qëllim pasurimin e metejshëm të fondit të bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNIEL ka një Bibliotekë Universitare Qëndrore pranë korpusit qëndror dhe biblioteka satelit, degë në cdo fakultet, cdo bibliotekë si ajo qëndrore ashtu dhe ajo e FSHMT kanë hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. (vizita e ambjenteve)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit dh ajo e FSHMT është e paisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka nje fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra apo revista shkencore. Megjithatë GVJ rekomandon që ajo duhet të pasurohet më tej me botime te fundit dhe me tituj të rinj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UNIEL ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. (EVIDENCA 3.7 Anetaresimi ne JSTORE dhe U-Library).</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, UNIEL ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. Institucioni po planifikon dhe ka projektuar digjitalizimit të fondit të bibliotekës për një qasje me komode në literature, process të cilin GVJ e inkurajon. (EVIDENCA 3.7 Anetaresimi ne JSTORE (EVIDENCA 3.8 Fondi i librit).</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 8.⁰⁰-19⁰⁰ cdo ditë të javës, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë rregjistrimi, Institucioni ka planifikuar gjithashtu pajisjen me karta elektronike. (EVIDENCA 4.10 Te dhena mbi orarin e shërbimit te Bibliotekes UNIEL).</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UNIEL planifikon do vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekse vijnë nga departamente e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e tekseve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Në analizën vjetore të UNIEL jepen të dhëna në lidhje me buxhetimin dhe numrin e titujve të cilët janë në rritje, nuk ka të dhëna konkrete në lidhje me shfrytëzimin e sallave të studimit apo të shfrytëzimit të literaturës on line , gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët u deklarua se ata e shfrytesojne në mënyrë të kënaqshme fondin e e bibliotekës kryesisht atë on-line.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UNIEL ka një Bibliotekë Universitare Qëndrore pranë korpusit qëndror dhe biblioteka satelit, degë në cdo fakultet, cdo bibliotekë si ajo qëndrore ashtu dhe ajo e FSHMT kanë hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Nga ana e GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 8.⁰⁰-19⁰⁰ cdo ditë të javës. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse pothuajse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. UNIEL ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. Institucioni po planifikon dhe ka projektuar digjitalizimit të fondit të bibliotekës për një qasje me komode në literature, process të cilin GVJ e inkurajon.</p>

	<p><i>GVJ evidenton që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekesore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogeve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UNIEL.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UNIEL disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin EMS. Sekretaria mesimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri themelatrë të studentëve • Rregjistri me të dhënat akademike • Rregjistri i lëshimit të diplomave <p>Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës • Proçes verbalet e testime në provime . • Dosjet e diplommit; • dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës • listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mesimore, dekani i fakultetit. Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuara në manualin e përdorimit të sistemit UMS nga secili prej përfituesve të tij .</p> <p>(EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS)</p> <p>(EVIDENCA 3 .14 Funkcionet dhe kompetencat/</p>

	(EVIDENCA 2.26 Cilesia ne hyrje dhe ne dalje "Bachelor ne Infemieri e Pergjithshme")
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik , ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores të sipërcituar. Stafit akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin EMS, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njëjësive kryesore (fakultetit) pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe administrative, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifën e studentëve dhe pagesat e kryera. Institucioni disponon sistemin e tij elektronik të të dhënave EMS dhe [ëëë.uniel.ems.al]. si dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentet, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studenteve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit zyrtare (@uniel.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional, dhe të jashtëm.</p> <p>(EVIDENCA 4. I I Rregulloja EMS)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Sic u theksua me lart cdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Sistemi EMS ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve, por këto nuk janë ende të aktivizuara. Përgjatë periudhës së Pandemise Covid-19 i gjithë sistemi i mësimdhënies akademike u realizuar me Microsoft Teams, i cili vazhdon të përdoret për shkëmbimin e informacioneve , materialeve akademike e studimore.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultate etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja Zyrtare e Universitetit "Aleksander Xhuvani" Elbasan është : ëëë.uniel.edu.al. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UNI, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UNIEL dhe fakultete, stafin</p>

	<p>akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionin UNIEL, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj.</p> <p>Faqja zyrtare në ëeb aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe.</p>			
Konkluzione	<p>UNIEL disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin EMS. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët, cdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale.</p> <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit . Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuar në manualin e përdorimit të sistemit UMS nga secili prej përfituesve të tij .</p> <p>Faqja Zyrtare e Universitetit “Aleksander Xhuvani” Elbasan është: eeë.unieleu.al. Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën.</p> <p>Faqja zyrtare në ëeb aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon realizimin e kësaj faqeje edhe në gjuhë angleze.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5



Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik UNIEL harton cdo vit një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Hartimin e këtij plani e realizon Drejtoria ekonomike dhe buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Fondet burojnë nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik.</p> <p>(EVIDENCA 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022); (EVIDENCA 4.15 Miratimi regjistrimit të prokurimeve dhe shërbimeve); (EVIDENCA 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi). EVIDENCA 4.17 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit aktual (2020 dhe 2022), Departamenti i Infermieristikës)</p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Çdo vit akademik FSHMT në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifën e shkollimit për çdo program bazuar në VKM 638 datë 22.07.2015. Tarifat e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese. Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga MARSH dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditi vlerëson aktivitetin financiar të institucionit.</p> <p>GVJ nuk gjeti të dhëna për auditim të brendshëm financiar të institucionit.</p> <p><i>Gjithashtu GVJ nuk gjen të dhëna për financimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen për punën kërkimore shkencore të pedagogëve, mendojmë dhe inkurajojmë Institucionin që të devijojë apo të punojë më shumë për sigurimin e fondeve kërkimit shkencor dhe investimit në laboratore me qëllim kërkimor kryesisht ë fushën e mjekësisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit i cili është i aksesueshëm dhe në faqën zyrtare të institucionit www.uniel.edu.al. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare (grante, projekte) për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>EVIDENCA 4.16 (Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit,plani për mbështetjen financiare per nje cikël te plots studimi)</p> <p>EVIDENCA 4.17 Kërkesa per parashikime financiare per buxhetin e vitit aktual (2020 dhe 2022), Departamenti i Infermieristikës (EVIDENCA 4,13 Raporti i Auditit KLSH 2022)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MARSH të ardhurat nga shërbimet që kryhen.</p>

Konkluzione	<p>Çdo vit akademik UNIEL harton cdo vit një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Çdo vit akademik FSHMT në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve.</p> <p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MARSH të ardhurat nga shërbimet që kryhen.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, kanë hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e UNIEL, rregulloret e FSHMT dhe rregulloret e Departamentit të Infermieristikës dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Në rregulloren e departamentit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Pranë departamenteve të FSHMT funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit. (EVIDENCA 1.1 ; Statuti UNIEL (Kreu VII, Neni 47, Pika 4 dhe Neni 49)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHMT ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Para cdo viti akademik pas kërkesës së MASR, departamenti përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të cilat aprovohen nga Senati akademik. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike. Senati akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MASR. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit. Në këto kriteret përfshihen dhe parashikohet është regjistrimi i studentëve të huaj. <i>Për programin e studimit Infermieri e pergjithshme GVJ evidenton që institucioni nuk ka përcaktuar kriteret specifike, përveç kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit.</i> Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve. (EVIDENCA 2.22 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit "Bachelor në Infermieri e Pergjithshme)</p>

	(EVIDENCA 5. I Vendimi i Senatit Akademik per kapacitetet 2022-2023)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Në rregulloren e departamentit, në statut dhe në ëeb janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Organizimin e programeve të studimit – Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë – Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave – Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi – Rregullat e ekuivalentimit etj. <p>Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.</p> <p>Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen ëeb të Universitetit të Elbasanit. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statut dhe rregulloren e departamentit përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara.</p> <p>(EVIDENCA I.7 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjeksore Teknike); (EVIDENCA I.8 Rregullore e programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Përgjithshme)</p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>UNIEL dhe FSHMT kanë në traditën e tyre organizimin e ditëve të hapura informuese në të cilat, prindër dhe gjimnazistë nga gjimnazet e qarkut të Elbasanit dhe të qarqeve fqinje (të cilët janë burimi kryesor i studenteve që frekuentojnë këtë univesitet) të cilët janë të interesuar për programet e studimit informohen nga pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete organizohen zakonisht në periudhën mars – maj dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t’u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen ëeb të UNIEL.</p> <p>EVIDENCA 5.2 Kalendar i diteve te hapura) (EVIDENCA 4.12 te dhena mbi publikimin ne faqen EEB) EVIDENCA 5.4 fletepalosja promovuese institucionale)</p>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>UNIEL parashikon kuota te posatëshme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi te vecanta, të pakicave dhe shtresave te marginalizuara, këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara cdo viti akademik.</p> <p>(EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023)</p>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, UNIEL dhe Departamenti harton dhe publikon përpara cdo viti akademik kriteret për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 56

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. (EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023)		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UNIEL, cdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselente në varësi të aaritjeve akademikeve.. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UNIEL. (Evidenca 2.1 Vendimi I Bordit të Administrimit për Bursat dhe Përjashtimet).		
Konkluzione	IAL ka hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhezimeve të Ministrisë së Arsimit. <i>Për programin e studimit Infermieri e pergjithshme GVJ evidenton që institucioni nuk ka përcaktuar kriteret specifike, përveç kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit.</i> Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve. UNIEL, cdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë për studentët ekselente në varësi të aaritjeve akademikeve, dhe për studentët nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit: 1. Frekuentimi i leksioneve, si rregull, është fakultativ. Në përputhje me specifikat e veta, në rregulloren e brendshme të programve të studimit mund të përcaktohen lëndë, frekuentimi i leksioneve të cilave mund të jetë i detyrueshëm deri në masën 80%. 2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%. 3. Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%. Kur studenti nuk ka frekuentuar deri në 25% të laboratorëve të cdo lënde, i

	<p>shlyen ato ne dy javet e fundit te vitit ne vazhdim, apo semestrit kur lenda eshte semestrare. Kur studenti ka frekuentuar me pak se 75°/o te tyre, i shlyen ato ne vitin pasardhes</p> <p>4. Frekuentimi i praktikave profesionale /mesimore/ spitalore eshte i detyrueshem ne masen 100%. Në këtë program studimi nuk parashikohet kushtezim midis lendeve. Në sekretarine mesimore te FSHMT mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mesimor nga studentet e cdo grupi mesimor, i cili plotesohet për cdo orë mësimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin.</p> <p>1. Studenti kalon nga viti i pare ne vitin e dyte, kur ka siguruar te pakten 20 kredite te vitit te pare. 2. Studenti kalon nga viti i dyte ne vitin e trete, kur ka siguruar te pakten 20 kredite nga viti i dyte dhe jo ut pak se 40 kredite nga viti i pare. 3. Studenti, cili nuk ploteson kushtet per te kaluar ne vitin pasardhes konsiderohet perserites i vitit akademik.</p> <p>(EVIDENCA I.2 Rregullore e Studimeve UNIEL) (EVIDENCA I.7 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike) (EVIDENCA I.8, Rregullore e programit te studimit "Bachelor n6 Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në të dy rregulloret ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët informohen përmes sekretarisë mësimore dhe Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në departament ngrihet një komision i posatshëm i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>(EVIDENCA I.2 Rregullore e Studimeve UNIEL) (EVIDENCA I.7 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike) (EVIDENCA I.8, Rregullore e programit te studimit "Bachelor n6 Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve/provimeve me shkrim/ me goje/ projekteve/ prezantimeve/ praktikave.</p> <p>Në programin e lëndeës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studenteve me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit, vlerësim i cili përbëhet nga dy komponentë – Provim me shkrim (kolokium)

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e vazhduar gjatë semestrit (detyra kursi, projekte, frekuentim, aktivizimi në seminare) • Vlerësimi me provimin përfundimtar. <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet në planin mesimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar</p> <p>Në syllabuse përcaktohet në mënyrë të detajuar pragu i pikëve kaluese dhe konvertimi i pikëve në nota. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p>(EVIDENCA 2.5 Programet lendore te programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme")</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka përgatitur dhe një manual (evidenca 3.10) instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Në rregullore përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome <ol style="list-style-type: none"> 1. Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimimit dhe rivlerësimit. 2. Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës. - Kushtet që duhet të përmbushë student për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës). Në fillim të vitit të fundit të studimeve, njësisia bazë ne bazë të suksesit së dy viteve të para përcakton studentët të cilët mund të mbyllin studimet me temë diplome.</p> <p>(EVIDENCA 3.10 Manuali i punimit të diplomës)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj) për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Informacioni përditësohet dhe në faqen eeb të UNIEL. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rrealizojnë gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</p> <p>(EVIDENCA 5.3 Publikimi i spotit promovues) (EVIDENCA 5.2 Kalendari i diteve te hapura 2022) (EVIDENCA 5.4 Fletepalosjet promovuese institucionale).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin dhe gjithashtu është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</p>

	<p>Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjeshme.</p> <p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</p> <p>Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës. Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj) për gjimnazistët dhe prindërit e interesuar. Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb të UNIEL. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rrealizon gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët që ndjekin programet mësimore Bcs në Infermieri të Përgjithshme informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Sekretarise Mësimore dhe sistemit EMS ato gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit – Informacion për objektivat formuese të programit – Strukturën dhe organizimin e programit – Planin mësimor – Syllabuset – Rregulloren – Suplementin e diplomës
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studentit gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studentit orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të irës së mësimin (leksion, seminar, praktikë).</p> <p>Studenti i merr të dhënat si nga sistemi EMS gjithashtu edhe nga faqja ëeb e Institucionit.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e	Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 60

<p>punësimin, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>punësimin. Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësore dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë process luan eshre Zyra ALUMNI. Institucioni merr informacion dhe nga portali Infermierë për Shqipërinë. Institucioni ka mundësuar përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitehs informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve edhe me anë të krijimit të Bordit të Këshillimit të Biznesit. Pjesmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës. Njëkohësisht Institucion depoziton të dhëna në lidhje studentët të cilët përfitojnë nga program i nxitjes së punësimin.</p> <p>(EVIDENCA 3.9 Lista e aktiviteteve Bordit të Këshillimit të Biznesit.) (EVIDENCA 5.5 Te dhena mbi studentet përfitues të programit të nxitjes së punësimin)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimin, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitalet rajonale. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë.</p> <p>(EVIDENCA 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen e ëeb) (Eviencia 4.6 Te dhëna mbi kapacitetet dhe infrastruktuen e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike)</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në RVB theksohet se UNIEL ka një sistem informatik të brendshëm EMS, përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në cdo moment. Vec detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. Informacioni i detajur dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen ëeb të Instucionit.</p> <p>(EVIDENCA 4. I I Rregullorja EMS). (EVIDENCA 4.12 Te dhena mbi publikimin ne faqen ëeb)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Studentët që ndjekin programin mësimore Bcs në Infermieri të Përgjithshme informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimin, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Në sekretarinë mësimore të FSHMT janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi. Sekretaria ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve - Regjistrin e lëshimit të diplomave - Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave) <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve dhe disponon të dhëna të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit.</p> <p>(EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/ 2021- 2022)</p> <p>(EVIDENCA 2.26 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studenteve në programin e studimit "Bachelor ne Infermieri e përgjithshme)</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjen nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të cregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin EMS dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore.</p>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat.</p> <p>Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit nga dy struktura perkatëse. Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Ato janë të disponueshme si në sekretarinë mesimore ashtu edhe në sistemin EMS, këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, infomacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 62

	konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UNIEL .		
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	UNIEL ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrolle periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mesimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.		
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i Infermierit. Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesit e FSHP, GVJ kërkoi informacion mbi licensimin dhe punësimin e studentëve të programeve të studimit të FSHMT. GVJ u informua se kalueshmëria në provimin e licensimit është mbi 90% në nivel fakulteti. Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Zyra së Alumni realizon skedimin i informacionit për punësimin. (EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/ 2021- 2022) (EVIDENCA 5.13 Të dhëna mbi licensimin e studenteve nga Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë)		
Konkluzione	Në sekretarinë mësimore të FSHMT janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse. Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i Infermierit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohej e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UA. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatit e UNIEL me dy senator të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në Bordin e administrimit, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promociionale e trajnuese të organizuara nga FSHMT. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit parashikohen qartë procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të elementëve të studimit. Në takimin me studentët ata vlerësojnë pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Studentët gjykojnë se praktikën në laboratorët simulatorë dhe praktikën profesionale në spitalet rajonale i përgatisin mjaft mirë për tregun e punës. Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmash. Këshilli studentor i cili funksionon në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHMT për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës, megjithatë GVJ evidenton që gjatë nuk ka ndryshime të kurrikulës gjatë viteve të fundit. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Në dokumentacion por dhe në takimin me studentët u evidentua përfshirja e tyre në përmirësimin e raportit teori-praktikë në lëndën e infermieristikës.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 64

	(EVIDENCA 2.3 Rregullore e Këshillit Sfudentor). (EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentet dhe Këshillimin e Karrierës)		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngrenjë komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili ben rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Në kuadër të marrveshjes për implementimin e sistemit CLEANSCORE procesi i vlerësimit të studenteve do jetë me transparent. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjeksores Teknike)/ (EVIDENCA 3.6 Marrveshje për implementimin e CLEANSCORE)		
Konkluzione	Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UNIEL me dy senator të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në Bordin e administrimit, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studenteve në procesin e rishikimit të kurrikulës, megjithatë GVJ evidenton që gjatë nuk ka ndryshime të kurrikulës gjatë viteve të fundit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>FSHMT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. – Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. – Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë – Zyra e Marrëdhënieve me jashtë – Zyra e IT. <p>Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve rubrikën e transparencës dhe Drejtoria e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në institucion funksionon Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë – Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës – Identifikimin e aftësive dhe shprehive <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në takimin e GVJ me Drejtoria e Këshillimit të Karrierës u informuam se kjo drejtori asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Drejtoria e Këshillimit të Karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave të cilat përditësohen cdo vit. Këto të dhëna gjurmimi e të studenteve pas perfundimit të studimeve u vihet në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studenteve të diplomuar dhe FSHMT-së dhe Departamentit të Infermierisë.</p> <p>(EVIDENCA 5.6 Te dhenat mbi punësimin e te diplomuarve 2020-2021 / 2021 -2022)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>FSHMT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>

	Në institucion funksionon Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre, kjo zyre mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data -bazë të të dhënave të cilat përditësohen cdo vit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një process i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p><i>UNIEL nuk ka hartuar ende një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i> Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme në të cilin UNIEL është partner. GVJ evidentoi që institucioni ka hartuar një udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional systemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçëshme periodikisht programet e studimit. Kështu pranë UNIEL- është ngritur dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon në fund të çdo semestri pyetësoret studenteve për matjen e performancës dhe cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ nuk evidentoi formë të tjera të drejtperdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. Bazuar në dokumentacion dhe gjatë takimeve me përfaqësues të zyrave GVJ evidenton që sistemi i sigurimit të cilësisë funksionon në rang institucional dhe nuk ka njësi të vecanta në çdo njësi kryesore.</i></p> <p>(EVIDENCA 5.9 Urdhëri për Komisionet e perhershme Institucionale në UNIEL) dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet.</p> <p>(EVIDENCA 5.10 Urdhëri për Komisionet e perhershme në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike)</p> <p>(EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022)</p> <p>(EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSBC të FSHMT)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucioneve të studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisionet e tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, dy herë në vit plotësojnë pyetësoret për vlerësimin e metodave të mësimdhënies. Në fund të çdo viti akademik Institucioni përpilon raportin bazuar në të dhënat e tërhequra nga këta pyetësore. Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin si të institucionit në përgjithësi ashtu është të programeve apo lëndëve specifike.</p> <p>(EVIDENCA 11 Statutit UNIEL)</p> <p>(EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022)</p>

	(EVIDENCA 5.9 Urdheri per Komisionet e perhershme Institucionale ne UNIEL.		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Sic u theksua dhe më lart pranë UNIEL-it funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetesorin e studenteve për matjen e performancës. Në fund të cdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetesorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi.</p> <p>Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat përgjegjëse hartojnë (institucioni) një raport në përfundim të cdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UNIEL-it. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i brendshëm i cilësisë".</p> <p>(EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022) (EVIDENCA 2.6 Strategjia e Departamentit të Infermieristikes) (EVIDENCA 2.16 Strategjia e Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike)</p>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p><i>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk gjen shembuj të promovimit të praktikave të mira me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mesim dhënies. GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë kryesisht përshkruese në terma sasiorë dhe jo analitike gjithashtu nuk evidentohet adresim i problematikave .</i></p>		
Konkluzione	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional systemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçëshme periodikisht programet e studimit. UNIEL nuk ka hartuar ende një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.</p> <p><i>GVJ nuk evidentoi forma të tjera të drejtperdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. GVJ evidenton që sistemi i sigurimit të cilësisë funksion në rang institucional dhe nuk ka njesi të vecanta në cdo njesi kryesore.</i></p> <p><i>GVJ nuk gjen shembuj të promovimit të praktikave të mira me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mesim dhënies. GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë kryesisht përshkruese në terma sasiorë dhe jo analitike gjithashtu nuk evidentohet adresim i problematikave .</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UNIEL dhe në rregulloren e institucionit. Në RVB evidentohet se politikat e sigurimit të cilësisë detajohen dhe në planet strategjike të institucionit. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. Në RVB gjejmë evidenca të vendimeve të senatit për aprovimin e pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative, vendimeve për aprovimin e formateve të vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>(EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL) (EVIDENCA 2.16 Strategjia e zhvillimit te Fakultetit te Shkencave Mieliesore Teknike) (EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSBC te FSHMT) (EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022). (EVIDENCA 6.3 Urdhrat per zhvillimin e pyetesoreve instucionale 2021-2022</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNIEL ka ngritur Drettorinë e Kurrikulave dhe të Sigurimit të Cilësisë . Pranë kësaj drejtorie funksionon NJSBC , dhe e bazon aktivitetin e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015 - Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018) - Statuti i institucionit - Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit</p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve . NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitetsh:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional. - Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në jësitë bazë. - Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. <p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNIEL i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë, duke marrë një akreditim maksimal prej 6 vite në akreditimin e dytë. GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC evidenton që institucioni përdor mekanizma të tillë si pyetsorët e vlerësimit të studentëve , vlerësimit të anëtareve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogeve.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UNIEL dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Metodatat të cilat aplikohen janë : pyetsorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura , intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat sipas gjykimit të GVJ, kanë nevojë të metejshme të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë .</p> <p>Kështu GVJ evidenton se vlerësimet e kryera për mësimdhënien (referuar pyetësorëve për studentin dhe vlerësimin e pedagogëve), janë vetëm përshkruese jo analitike , rezultojnë se pyetjet janë standarte pa përmbushje të qëllimit final të pyetësoreve.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat sipas gjykimit të GVJ, kanë nevojë të metejshme të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe</p>	<p>FSHMT përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 71




<p>mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>departamenti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza vjetore e departamentit - Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik - Pyetsori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të KUR-it në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve në RVB dhe gjatë diskutimeve me drejtuesit, një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj. Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe jo në funksion të cilësisë.</p> <p><i>GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishikimit më qëllim përmirësimin në këtë program studimi</i></p> <p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC</p> <p><i>Megjithatë, GVJ evidenton se raportimet vjetore janë kryesisht informative dhe jo në kontekstin e përmirësimit të cilësisë apo treguesëve të veçantë të saj.</i></p> <p>Për këtë arsye, njësia duhet të marrë rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standartë por përfshijë edhe metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve i përfaqësojnë realitetin në të cilin ndodhet institucioni NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e vet duke u bazuar në rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p>
---	--

	<i>GVJ rekomandon rritje e eficencës në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Njësia kryesore , në fund të cdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSHMT. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të UNIEL duke krijuar mundësi me të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Departamentet e FSHP analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë: <ul style="list-style-type: none"> – Numri i studentëve frekuentues – Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikve – Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore – Plotësimi i standarteve të stafit akademik – Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve – Kalueshmëria dhe cilësia semestrare – Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale – Numri i të diplomuarve – Kalueshmëria në provimin e shtetit – Raportet leksion /laborator – Konkluzionet e pyetsorit të studentëve
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim ze informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnipërmes kësaj zyre po realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës. (EviDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL) (EVIDENCA I.7 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore Teknike) (EVIDENCA 2.7 Rregullore e departamentit te Infermieristikes) (EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit te studimit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme)

	EVIDENCA 2.26 Procedura e ndjekur per permiresimin e kurrikules se programit "Bachelor ne Infermieri e Pergjithshme". (EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSBC te FSHMT)			
Konkluzione	<p>FSHMT përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.</p> <p>Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe jo në funksion të cilësisë. GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishikimit më qëllim përmirësimin në këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon rritje e efencës në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 20 të Universitetit "Aleksander Xhuvani", përshkruhet përbërja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit në përbërje të këtij komisioni janë 5 (pesë) anëtare, staf me kohë të plotë në FSHMT, nga të cilët 4 (katër) janë anetarë nga personeli akademik i UNIEL, që i perkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (nje) anëtar është përfaqësues i studenteve. 2-Anetarët e Komisionit, përfaqësues të UNIEL, vetkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Prania e studenteve si anëtare të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Rregullorja nuk përfshin përfshirjen e anëtareve të huaj. GVJ rekomandon përfshirjen edhe të aktoreve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>(EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe Funkcionimit UNIEL)</p> <p>(EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSBC te FSHMT)</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHP, Përgjegjësit e Departamenteve të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Infermierisë dhe Kujdesit Shëndetësor, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit, është konceptuar si Përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Harmonizimin e veprimtarisë të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit Bachelor në Infermieri; - Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe pëmirësuar cilësinë e programit të studimit; - Hartimin e një programi cilësor që plotëson nevojat e shoqërisë; - Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëpunuar konform rregullave, në harmoni të plotë. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësimin përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL) (EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSBC të FSHMT)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit "Bachelor në Infermieri e Përgjithshme", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, sic është Personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm I nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UNIEL. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve.</p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit institucioni nuk ka përfshirë eksperte të jashtëm, proces të cilin GVJ e inkurajon.</i></p> <p>Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ish të diplomuar, mjekë specialiste, eksperte të DSHP të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen me efikasitet me kërkesat e tregut të punës.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 20 të Universitetit “Aleksander Xhuvani”, përshkruhet përbërja E Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit në përbërje të këtij komisioni janë 5 (pesë) anëtare, staf me kohë të plotë në FSHMT <i>Rregullorja nuk përfshin përfshirjen e anëtareve të huaj. GVJ rekomandon përfshirjen edhe të aktoreve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i> GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe</p>	<p>NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSCB respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 76

legislacionin për të dhënat personale.	komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e ueb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. <i>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Prandaj <i>GVJ rithekson që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ nuk identifikoi veprimtari dhe informacione që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. <i>Për sa më sipër GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktiviteteve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Konkluzione	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve. <i>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktiviteteve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit ciklit të parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” është hartuar bazuar në modelet më të mira kombëtare dhe Europiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Stafit akademik është i kualifikuar dhe me përvojë për zbatimin e programit
3. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi ekspriencës të studentëve dhe pedagogëve me institucione të Arsimit të lartë në vënde europiane (Itali, Poloni, Rumani) të financuar nga Erasmus+ .
4. Marrëveshjet me institucionet shëndetësorë publike dhe privatë për realizimin e praktikës profesionale.
5. Mbështetje financiare për studentët për zhvillimin e temave apo studimeve të diplomës duke i financuar ata për pjesëmarrje në konferenca studentore ndërkombëtare si dhe botim të punimeve të tyre në Buletinin Shkencor periodik.
6. Institucioni ka një databaza për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe atyre që kanë përfunduar studimet prej të cilëve mer dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.



Pika të dobta:

1. Në disa raste titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor sipas përcaktime ligjore. **(standardi II.3, kriteri 4)**
2. Verëhet mbingarkesë në orë mësimore e stafit akademik si dhe në disa raste nuk përputhet formimi profesional i pedagogut me lëndën që zhvillon në këtë program studimi. **(standardi II.3, kriteri 4); (standardi III.1, kriteri 4)**
3. Proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, kanë nevojë të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. **(standardi VI.1; VI.3)**

Rekomandime:

1. Rishikimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore sipas formimit profesional, gradës së kualifikimit si dhe grupimin e lëndëve sipas tipologjive të ngjashme.
2. Rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe emërtimi nga kategoria professor dhe lektorët të jenë të kategorisë “Doktorë i shkencave”.
3. Realizimin e faqes së Universitetit edhe në gjuhë angleze.

4. Instutucionin të punojë më shumë për sigurimin e fondeve për kërkim shkencor të pedagogëve dhe investimit në laboratore me qëllim kërkimor kryesisht në fushën e mjekësisë.
5. Rinovimi i marëveshjeve të bashkëpunimit bazuar në afatet kohore të bashkëpunimit.
6. Pasurimin dhe përditësimin e literaturës mjekësore me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogëve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UNIEL, për rritjen e buxhetimit apo sigurimin e fondeve.
7. Rritje të efikasitetit në analizimin e informacionit dhe të dhënave të aktivitetit të programit të studimit, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.
8. Shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktiviteteve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Nursing" of Higher Education Institution University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

Strength points:

1. Curriculum of the study program of the first cycle Bachelor in "Nursing" is designed based on the best national and European models, respecting the standards and legal framework in power.
2. The academic staff is qualified and experienced in implementing the program
3. Cooperation and exchange of experience of students and lecturers with institutions of higher education in European countries (Italy, Poland, Romania) financed by Erasmus+ program.
4. Agreements with public and private health institutions for the realization of professional practice.
5. Financial support to students for the development of diploma topics or studies by financing them for participation in international student conferences as well as publication of their works in the periodic Scientific Bulletin.
6. The database for in the study programs as well as those who have completed their studies, from which it receives information about labour market requirements and student employment opportunities.

Weak points:

1. In some cases, the head of the course is not of the Professor category according to legal regulations. **(standard II.3, criterion 4);**
2. There is an overload in the teaching hours of the academic staff, as well as in some cases the professional background of the lecturer does not match the subject he teach in this study program. **(standard II.3, criterion 4); (standard III.1, criterion 4)**
3. The internal processes of quality assurance need to be consolidated and standardized as permanent processes which are performed both at the institutional level and at the study program level, performing analytical and comparative evaluations, as well as other processes that promote and improve quality. **(standardi VI.1; VI.3)**



Recommendations:

The external evaluation team recommends the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

1. To review the distribution of the workload according to the professional training, degree of qualification of the academic staff as well as the grouping of subjects according to similar typologies.



2. Review of course holders and appointment “course holders” from the academic staff of the professor category. The lecture to be from the "Doctors of Sciences" category.
3. Setting the University website in English language.
4. The institution should work more to secure funds for scientific research of pedagogues and investment in laboratories for research purposes mainly in the field of medicine.
5. Renewal of cooperation agreements based on cooperation timelines.
6. Enrichment and update of medical literature through a better cooperation between lecturers, administrative and management staff of UNIEL, for increasing budgeting or securing funds.
7. Increasing efficiency of information analyzing and data of the study program activity, in compiling more detailed recommendations and a work plan with concrete addressing of problems.
8. To perform more activities and increasing their efficiency with staff and students, aiming information and raise their awareness for ensuring and improving the long-term quality of the study program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X